

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

T H Ë R R A S

Mbledhjen e LV-të (pesëdhjetepesë - mandati VII)-e rregullt, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **26 qershor 2025, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunën e Podujevës, në orën 10:00**, dhe propozoj këtë;

REND TË DITËS

1. Korniza Afatmesme Buxhetore-KAB e Komunës së Podujevës, për vitet 2026/2028
2. Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri
3. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal Për Siguri Në Bashkësi-KKSB për vitin 2024
4. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0022129/25 datë 18.04.2025 për ndryshim dhe plotësim të përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa
- *Kërkesa e MAPL-së nr.020-2/8 datë 30.05.2025.*
5. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2024
-Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit
6. Të ndryshme

Nr.Prot.01-060/01-060/03-0033581/25
Podujevë, datë; 17 qershor 2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E FINANCAVE

**KORNIZA AFATMESME
BUXHETORE**

2026-2028

Podujevë

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2026-2028

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Komunës së Podujevës, është dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, që do të pasqyrojë caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike duke marrë për bazë nevojat e grave dhe burrave për të përmbushur objektivat e përcaktuara zhvillimore të Komunës së Podujevës.

Si pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme buxhetore (KAB), është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2026-2028, të dhëna nga Ministria e Financave (MF), përmes Qarkores buxhetore për komunat, si dhe financimi nga grantet qeveritare dhe kufijtë fillestarë të buxhetit komunal për vitin 2026 dhe parashikimet, që janë miratuar nga Komisioni i Granteve, si pjesë integrale e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH), e miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Në Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028 i është kushtuar rëndësi aspektit të barazisë gjinore.

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit, që bën ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare. Çdo program buxhetor është trajtuar me kujdes për plotësimin e nevojave dhe kërkesave me komponentë të ndjeshme gjinore. Secili program përmban karakteristika të buxhetit të përgjegjshëm gjinor për ofrimin e shërbimeve të barabarta për të dy gjinitë.

Me Kornizën afatmesme buxhetore – komunale, do t'i paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Podujevës, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën, me të cilën buxheti i Komunës do t'i përmbushë dhe përkrahë projektet me prioritet, që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2026 – 2028, gjithnjë duke u bazuar në:

- Ligjin për financat e pushtetit lokal;
- Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Ligjin për vetëqeverisjen lokale;

- Ligjin për kufijtë administrativë komunalë dhe
- Ligjin e buxhetit.

MISSIONI

Komuna e Podujevës përkushtohet në përmirsimin e jetës së grave dhe burrave, në zhvillimin e qëndrueshëm, rritjen e mirëqenies sociale dhe ekonomike, ofrimin e arsimit cilësor, zhvillimin e turizmit, promovimin dhe përkrahjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive, si dhe administratë efikase.

OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2026-2028, planifikohet në bazë të Buxhetit, i cili bazohet në Buxhetin e programeve dhe është i bazuar në objektivat dhe në deklaratat e misioneve të programeve. KAB-i komunal 2026-2028, është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores buxhetore, e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritetet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve. Në KAB-në komunale paraqiten edhe deklaratat dhe misionet e drejtorive lidhur me punën e tyre pasuese trevjeçare.

Objektivat e Komunes së Podujevës

- Përmirësimi i infrastrukturës në qytet: ndërtimi i rrugëve të reja, zgjerimi i rrugëve egzistuese, ndërtimi i trotuarëve, zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik, ndërtimi i shtigjeve për biçikleta etj.
- Përmirësimi i infrastrukturës në fshatra: ndërtimi i rrugëve të reja, ndërtimi i trotuarëve, zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik, ndërtimi i shtigjeve për biçikleta etj.
- Krijimi i një qyteti të zhvilluar me plan urbanistik
- Ngritja e nivelit të arsimit, duke krijuar kushte të mira për zhvillimin e arsimit dhe duke e lidhur me ekonominë, duke ndërtuar objekte të reja arsimore, renovimin e objekteve egzistuese, digjitalizimin e institucioneve arsimore etj.
- Zhvillimi i shëndetësisë duke krijuar shërbime cilësore për qytetarët

- Rritja e mirëqenies sociale, duke mbështetur zhvillimin ekonomik si dhe duke përkrahur grupet në nevojë të burrave dhe grave
- Zhvillimi i kulturës, rinisë dhe sportit për të rinjtë dhe të rejtat e Komunës së Podujevës
- Përkrahja e bizneseve në mënyrë që të ulët papunësia, ngritja e parkut industrial, subvencionimi i ndërmarrjeve të vogla, subvencionimi i bujqëve, mbështetja e punësimit të grave dhe subvencionimi i biznesit të grave etj.
- Zhvillimi i turizmit, duke promovuar resurset natyrore dhe kulturore të Komunës së Podujevës
- Zhvillimi i bujqësisë duke subvencionuar bujqit burra dhe gra të Komunës së Podujevës

Këto objektiva të Komunës së Podujevës janë objektiva që perputhen edhe me objektivat e Qeverisë së Kosovës të cilat janë të shprehura në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe në programin e Qeverisë.

Objektivat dhe përfitimet e procesit të Kornizes Afatmesme Buxhetore për vitet 2026-2028

a) Shtimi i efikasitetit dhe efektivitetit:

- Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal;
- Planifikimi i buxhetit në kode ekonomike;
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve;
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve;
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur dhe cilësore;
- Përzgjedhja e punëve me prioritet për realizim.

b) Rritja e të hyrave vetanake:

- Rritja e efikasitetit në arkëtim;
- Rritja e bazës së tatimpaguesëve.

c) Kontrolli dhe reduktimi i shpenzimeve

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme;

- Planifikimi i shpenzimeve me kohë;
- Përparësia nga blerja me shumicë;
- Përmirësimi i performancës për mallra dhe shërbime;
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat kornizë.

d) Ngritja e kapaciteteve njerëzore

- Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore;
- Përdorim i software-ve të avancuar për shërbime;
- Profesionalizimi i shërbimeve.

e) Sigurimi i disiplinës financiare:

- Harmonizim me politikat financiare, ligjet, rregulloret dhe me udhëzimet administrative;
- Ekzistenca e kontrolleve interne – auditori i brendshëm dhe implementimi i rekomandimeve;
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik;
- Analiza të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve;
- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme (Kesh plani);
- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas programit të BDMS – SZHMB;
- Planifikimi dhe realizimi investimeve kapitale sipas programit të PIP-së (Programi i investimeve publike);
- Respektimi i Ligjit të buxhetit - mos hyrja në obligime pa mbulesë - zotim të mjeteve.

f) Ekonomia:

- Zhvillimi i Strategjisë komunale për promovim ekonomik;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për donatorë të brendshëm dhe të jashtëm;
- Krijimi i kushteve për prodhuesit vendorë;
- Mbështetje buxhetore për fermerët;

- Korniza Afatemeseme Buxhetore 2026-2028 është e përpiluar në përputhje me Qarkoren Buxhetore për komuna 2026 dhe Ligjit mbi Menaxhmin e Financave dhe kjo kornizë duhet të përmbajë strategjinë fiskale të Komunës për periudhën e ardhshme tre vjeçare.

Tabela 1: Buxheti i Komunës sipas Qarkores Buxhetore 2026/01

Organizatrat buxhetore	Aktuali	Plani	Projeksione	
	2025	2026	2027	2028
Granti i Pergjithshëm	14,627,269	14,627,269.00	15,627,262	16,884,235
Granti i Arsimit	13,190,988	13,690,040.00	14,100,741	14,523,764
Sherbimet Rezidenciale	150,000	230,000.00	400,000	400,000
Granti nga Shëndetësia pri	3,347,173	3,687,591.00	3,798,218	3,912,165
Teatri "Avdush Hasani"	157,349	185,729.00	195,944	206,721
Te hyrat vetanake	1,986,336	2,358,325.00	2,518,647	2,527,090
TOTALI	33,459,115	34,778,954.00	36,640,812	38,453,975

Parashikimi i të hyrave vetanake

- Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës realizohen në bazë të ligjit për financat e pushtetit lokal, rregulloreve komunale si dhe dispozitave të tjera ligjore, të cilat i përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale, të cilat komuna ka të drejtë ti arkëtojë.
- Bazën e të hyrave vetanake komunale në Komunën e Podujevës e përbën Tatimi në Pronë.

Të hyrat e Komunës për periudhën 2026-2028, parashihen të arkëtohen nga:

- Tatimi në pronë
- Tatimi në tokë
- Taksa për leje ndërtimi
- Taksa administrative komunale
- Taksa për automjete motorike
- Taksa për çertifikata
- Qira nga objektet
- Qiraja për tokën
- Participimi në shëndetësi
- Participimi në arsim

Tabela 2. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale

	2024	2025	2026	2027	2028
	(aktuali)	(aktuali)	(plani)	(vlerësimet)	(vlerësimet)
TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	31,423,020	33,459,115	34,778,954	36,640,812	38,453,975
TË HYRAT VETANAKE	1,859,659	1,986,336	2,358,325	2,518,647	2,527,090
Tatimi në Pronë	705,256	631,226	692,704	742,925	750,354
Tatimi në Tokë	143,739	143,316	167,622	202,822	203,836
Taksat Komunale	670,664	811,794	1,067,999	1,157,900	1,152,900
Licencat dhe lejet	98,000	120,000	162,000	170,000	170,000
Certifikatat zyrtare	110,000	120,000	155,000	175,000	175,000
Taksat për automjete	71,000	95,000	130,000	130,000	130,000
Lejet e ndërtimit	296,664	356,794	430,000	490,000	490,000
Taksat e tjera Komunale	95,000	120,000	190,999	192,900	187,900
Agjensioni i pyjeve					
Ngarkesat Komunale	290,000	400,000	430,000	415,000	420,000
Ngarkesat rregullative					
Qiraja	129,000	110,000	130,000	110,000	110,000
Bashkë-pagesat arsim	75,000	150,000	150,000	150,000	150,000
Bashkë-pagesat shënd.	72,000	80,000	80,000	80,000	80,000
Ngarkesat tjera komunale					
Të hyrat tjera	25,000	30,000	35,000	40,000	45,000
Gjobat e Gjykates	25,000	30,000	35,000	35,000	35,000
TRANSFERET QEVERITARE	29,563,361	31,472,779	32,420,629	34,122,165	35,926,885
Granti i Përgjithshëm	12,409,699	14,063,872	14,812,998	15,823,206	17,090,956
Granti për Arsim	9,859,607	12,086,230	13,690,040	14,100,741	14,523,764
Granti për Shëndetësi	3,330,767	3,413,259	3,917,591	4,198,218	4,312,165

Korniza komunale e shpenzimeve buxhetore

Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik fiskal dhe duke pasur për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2025.

Kjo kornizë paraqet parashikimin 3 vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale. Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të rritjes për çdo vjet si dhe rritje të granteve të qeverisë të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të buxhetit të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i granteve të MF-it.

Të gjitha programet buxhetore kanë elemente të plotësimit të nevojave të burrave dhe grave .

Buxheti i Komunës për vitet 2026 – 2028

Buxheti i Komunës për vitin 2026/28

Qarkorja -2026/01

Nr.	Emertimi i Drejtimit	kodet	kodi-f	stafi	Paga	Mallra	Komunal	Subvencio	Kapitale	Totali-2026	Totali-2027	Totali-2028
1	Zyra e Kryetarit	160/16005	111	18	210,812					210,812	219,245	228,015
2	Zyra e Kuvendit	169/16905	111	36	334,868	20,000				354,868	373,263	387,194
3	Administrata	163/16305	133	64	531,124	252,000	452,012		220,000	1,455,136	1,298,369	1,316,267
4	Buxhet dhe Financ	175/17505	112	19	190,870					190,870	198,505	206,446
5	Planifikim dhe Zhv	480/48005	411	9	92,680	40,000			300,000	382,680	246,388	1,050,244
6	Inspektimet	166/16609	411	17	218,091	55,000				273,091	281,815	290,888
7	Bujqësia	470/47005	421	8	82,524	30,000			600,000	712,524	918,945	1,222,503
8	Kadastr dhe Gjeod	650/65025	610	18	171,793	10,000				181,793	178,665	185,817
9	Planifikim Urban	660/66030	620	15	157,575	190,000			2,162,000	2,509,575	2,923,878	3,085,434
10	Infrastruktur Publi	180/18165	451	13	158,720	1,155,000			2,029,090	3,342,810	3,749,472	3,284,582
11	Zjarrfiksit	180/18225	320	18	194,298					194,298	202,070	210,153
12	Kultura Rini e Spor	850/85005	820	17	159,105	70,000			200,000	429,105	440,470	352,089
13	Teatri Avdush Hasani			12	142,432			42,585		185,017	193,130	199,056
13	ZKK	195/19725	1090	2	22,023					22,023	22,904	23,821
	Administrata (A)	920/92025	980	12	118,961					118,961	123,720	128,669
	Administrata (SH)	730/73014	760	10	100,074					100,074	104,077	108,241
	Sherbimet reziden	75522		13	121,808				230,000	351,808	326,681	531,749
	Shërbimet Sociale	755/75521	1040	13	123,427					123,427	328,365	133,450
	Totali i Gran. Pergjithshem			314	3,131,185	1,822,000	452,012	42,585	5,691,090	11,138,872	12,129,962	12,944,618
14	Arsim dhe Shker	920/911	912/92	1471	13,933,951	1,050,000	137,000	120,000	2,250,000	17,540,951	18,153,309	19,022,961
15	Shendetsia (QKN	730/73300	721	274	2,702,206	763,000	105,600		170,000	3,740,806	3,838,894	3,959,306
	Totali			2059	19,767,342	3,635,000	694,612	162,585	8,161,090	32,420,629	34,122,165	35,926,885

TE HYRAT VETANAKE

Programet	Stafi	Paga	Mallra	Komunal	Subvencione	Kapitale	Totali-2026	Totali-2027	Totali-2028
Administrata					-			-	-
Infrastruktur Publike					130,000	295,910	425,910	538,647	397,090
Planifikim dhe zhvillim					300,000		300,000	350,000	350,000
Planifikim urban						300,000	300,000	200,000	300,000
Bujqesia					700,000		700,000	750,000	750,000
Kultur, Rini e Sport					150,000		150,000	200,000	250,000
Teatri					2,415		2,415	-	-
Arsim dhe Shkenc		105,000	45,000				150,000	150,000	150,000
Shendetsia (QKMF)		56,000	24,000				80,000	80,000	80,000
Administrata (SH)					250,000		250,000	250,000	250,000
Totali i THV		161,000	69,000	-	1,532,415	595,910	2,358,325	2,518,647	2,527,090
	2059	19,928,342	3,704,000	694,612	1,695,000	8,757,000	34,778,954	36,640,812	38,453,975

Tabela : Strategjia zhvillimore për sektorët komunal

Zyra e Kryetarit:

Kryetar: Z. Shpejtim Bulliqi

Komuna e Podujevës përkushtohet në përmirsimin e jetës së grave dhe burrave, në zhvillimin e qëndrueshëm, rritjen e mirëqenies sociale dhe ekonomike, ofrimin e arsimit cilësor, zhvillimin e turizmit, promovimin dhe përkrahjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive, si dhe administratë efikase.

Përgjegjësitë e Kryetarit

Kryetari i Komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:

- a) Përfaqëson Komunën dhe vepron në emër të saj;
- b) Udhëheq Ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyr administrimin financiar të Komunës;
- c) Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
- d) Ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës;
- e) Emëron apo shkarkon nënkryetarin e tij/saj;
- f) Emëron dhe shkarkon drejtorët, të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- g) Organizon punën dhe drejton politikën e Komunës;
- h) Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;
- i) Propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- j) Raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës; dhe
- k) mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve; dhe
- l) Aktivitetet tjera që i caktohen me Statut.

Buxheti i planifikuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve,

Buxheti për zyrën e Kryetarit

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	210,812	219,245	228,015
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	210,812	219,245	228,015

	Stafi	18	18	18
--	--------------	----	----	----

Zyra e Kuvendit Komunal

Deklarata e misionit:- Përgatitja e të gjitha materialeve për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, në kuadër të kompetencave dhe fushë veprimtarisë të nivelit të qeverisjes lokale (nxjerrja e rregulloreve, vendimeve etj.) në funksion të qeverisjes sa më të mirë dhe efikente të të gjitha drejtorive të Shërbimit civil të Komunës, gjithnjë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Komunës.

-Koordinimi i punëve me të gjitha drejtoritë e Shërbimit civil të Komunës, këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, Komiteteve obligative dhe Komiteteve jo obligative, komiteteve konsultative dhe KKSBB me subjektet relevante të Nivelit Qendror dhe atij lokal, OJQ-të, bizneset, etj, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të Komunës në përgjithësi dhe me këtë edhe të ngritjes së mirëqenies për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës

Buxheti për Zyrën e Kuvendit Komunal

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	334,868	348,245	362,194
2	Mallra dhe shërbime	20,000.00	25,000.00	25,000.00
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
		354,868	373,263	387,194

	Stafi			
--	--------------	--	--	--

Drejtoria për Administratë

Bënë zbatimin e dispozitave ligjore, akteve nënligjore si dhe akteve të përgjithshme;

- Përgatitjen e materialit të Kryetarit të Komunës, të Kuvendit, Komiteteve dhe të Komisioneve tjera;
- Krijimin e kushteve të barabarta për qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të përcaktuara me ligj;
- Avancimin dhe organizimin e punës në organet komunale të Administratës;
- Lëshimin e certifikatave dhe akteve tjera që kanë të bëjnë me gjendjen statusore;
- Kryerja e punëve të përbashkëta për organet e Administratës si menagjimi dhe mirëmbajtja në përgjithësi e aparaturës kompjuterike në zyrat e Administratës, pranimin e parashtresave, dorëzimin dhe ekspeditimin e parashtresave,

Vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimeve, arkivimin e lëndëve, sigurimin e objekteve, mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre si dhe shfrytëzimin e automjeteve;

Objektivat:

Shërbime cilësore, efikase dhe transparente për qytetarët

Digjitalizimi i administratës

Buxheti për Drejtorinë e Administratës

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	531,124	552,369	574,464
2	Mallra dhe shërbime	252,000	278,000	273,803
3	Shpenzime komunale	452,012	468,000	468,000
4	Subvencione			
5	Investime kapitale	220,000		
	Gjithsej:	1,455,136	1,298,369	1,316,267

	Stafi	64	64	64
--	-------	----	----	----

Drejtoria për Buxhet e Financa

- Veprimtaria e Drejtorisë për Buxhet e Financa, është mbështetur në kompetencat e përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe implementimin e rregulloreve të aprovuara në Kuvendin e Komunës si dhe në bazë të instruksioneve financiare të aprovuara nga MEF-i dhe plan programeve të punës së drejtorisë.
- Drejtoria për Buxhet e Financa është përgjegjëse për:
 - Përgatitjen e buxhetit .
 - Përgatitjen e bazës ligjore për realizimin e buxhetit të planifikuar.
 - Menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit.
 - Përgatitjen e dinamikës së shpenzimit të buxhetit.
 - Rishikimin e buxhetit.
 - Menaxhimin e fondeve dhe monitorimin e sistemit në procesin e ekzekutimit të buxhetit.
 - Transferi i mjeteve vetanake dhe donatorëve në B.K.K.
 - Alokimin e mjeteve dhe zotimin e tyre sipas prioriteteve të caktuara.
 - Barazimin e të hyrave vetanake dhe shpenzimeve me Departamentin e Thesarit.
 - Menaxhimin e shpenzimeve.
 - Përgatitjen e pasqyrave financiare për MEF- in.
 - Përgatitjen e raportit financiar për Kuvendin e Komunës.
 - Bënë identifikimin , klasifikimin dhe vlerësimin e pronës në territorin e Komunës.
 - Ndhmon dhe këshillon komunitetin e biznesit në lëmin e tatimeve, taksave dhe obligimeve tjera ndaj Komunës

Buxheti për Drejtorinë për Buxhet e Financa

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	190,870	198,505	206,446
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	190,870	198,505	206,446

	Stafi	19	19	19
--	--------------	----	----	----

Drejtoria e Arsimit:

DKA-ja ushtron funksion dhe përgjegjësi në bazë të Ligjit lidhur me organizimin e arsimit për fëmijë dhe të rritur duke filluar nga niveli: 0,1,2 dhe 3 dhe të rriturëve në Komunë;

- Nxitë barazinë dhe mundësinë për të ndjekur arsimin parashkollor, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Komunë për të gjithë pa dallime gjinore dhe dallime tjera, në zhvillimin dhe aftësimin e personelit në të gjitha aspektet e tjera të arsimit;
- Respekton dhe nxit të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre;
- Nxitë bashkëpunimin mes mësuesve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore, familjes dhe komunitetit;
- Bën regjistrimin e të dhënave personale të nxënësve në një format të miratuar nga MASHT-i;
- Bashkëpunon ngusht me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në interes dhe bashkëveprim në mes dy palëve në interes të nxënësve;
- Planifikon zhvillimin e arsimit parashkollor fillor dhe të mesëm në Komunë, në konsultim me MASHT-in;
- Në marrëveshje me MASHT-in, miraton rregullat për themelimin, shkrirjen, ndarjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore me fonde publike të niveleve 0,1,2 dhe 3 në Komunë;
- Rregullon se cilat shkolla i përkasin zonave specifike të mbulimit në Komunë;
- Bën mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore me fonde publike si, mirëqenien fizike të nxënësve duke përfshirë me ujë të freskët, ambient të shëndetshëm, ambient rrethues nëpër shkolla;
- Nxit, në bashkëpunim me MASHT-in, politikën shoqërore dhe objektivat e shëndetit publik nëpërmjet aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore, duke përfshirë programe për sigurimin në rrugë, fusha dhe shëndetin e nxënësve duke ju shmangur sëmundjeve ngjitëse si dhe aksionit kundër duhanit dhe drogës;
- Miratimin e pushimeve lokale të shkollës me mundësi të barabarta për të gjithë;
- Miratimin e rregullave të shkollës;
- Punësimin dhe pagat për mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave të Komunës;
- Shqyrton masat lidhur me ankesat e nxënësve;
- Angazhohet për realizimin e arsimit special në konsultim me MASHT-in për nxënës me nevoja të veçanta;
- Miraton rregullat për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve të shkollave;
- Objektivat:
 - Ndërtimi i objekteve shkollore dhe sallave sportive
 - Renovimi i shkollave
 - Furnizimi me kabinete dhe teknologji bashkëkohore në shkolla
 - Përmirësimi i kushteve të nxënësve
 - Zhvillimi i aftësisë profesionale
 - Përmirësimi i cilësisë së arsimit
 - Barazi gjinore në institucionet arsimore

Buxheti për Arsimit

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	14,157,912	14,720,029	15,304,630
2	Mallra dhe shërbime	1,095,000	1,170,000	1,260,000
3	Shpenzime komunale	137,000	137,000	137,000
4	Subvencione	120,000	120,000	120,000
5	Investime kapitale	2,300,000	2,280,000	2,480,000
	Gjithsej:	17,809,912	18,427,029	19,301,630

	Stafi	1483	1483	1483
--	--------------	------	------	------

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:

- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale bënë organizimin, menaxhimin dhe monitorimin e mbrojtjes dhe kujdesit shëndetësor në mënyrë të vazhdueshme në tërë rrjetin shëndetësor të Komunës.
- Ofrimi me kohë dhe cilësor i kujdesit parësor shëndetësor në të gjitha institucionet shëndetësore (QKMF, QMF dhe PMF).
- Zbatimi i programit të imunizimit në tërësi, sipas PZI.
- Përcjellja e situatës epidemiologjike në vazhdimësi.
- Sigurimi i të dhënave dhe zbatimi i përpikët i sistemit informativ shëndetësor (SISH).
- Furnizimi me barëra nga lista esenciale dhe me materiale tjera ndihmëse të evidentuara në regjistrin zyrtar.
- Sigurimi i kuadrit dhe resurseve humane në të gjitha shërbimet, sipas kriterëve të OBSH.
- Aftësimi i kuadrove profesionale, qoftë me specializime apo trajnime të vazhdueshme.
- Përpilimi dhe implementimi i projekteve për investime kapitale dhe për situata tjera.
- Monitorimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore.
- Edukimi dhe arsimimi shëndetësor i popullatës, me prioritet grupet e rrezikut.
- Përcaktimi i prioriteteve në shëndetësi ndaj nënës dhe fëmijës, shëndeti mendor i bazuar në bashkësi, shëndeti oral dhe shëndeti stomatologjik etj.
- Hulumtimi, identifikimi dhe vlerësimi sistematik i shëndetit dhe ambientit jetësor
- Sigurimi i ujit dhe ushqimit cilësor.
- Përkujdesja dhe furnizimi me aparaturë më të sofistikuar për diagnostifikim
- Përkujdesja për shërbimin e transportit për qëllimet mjekësore, sipas standardeve bashkëkohore.
- Përmirësimi i pozitës materiale – stimulimi i punëtorëve shëndetësorë.
- Hulumtimi, identifikimi, përcjellja dhe përkujdesja për rastet sociale, të cilat kanë nevojë për asistencë.
- Përpilimi i projekteve dhe politikave për ndihmë familjeve të rrezikuara.
- Realizimi i të drejtave dhe obligimeve për kategoritë e caktuara (familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, invalidët civil, personat me aftësi të kufizuara, gratë kryefamiljare, fëmijët jetimë, personat e moshuar dhe ata të vetmuar).
- Identifikimi i rasteve që kanë të pagjedhur strehim-banimin.
- Koordinimi i punëve me subjektet që kanë mundësi për zgjedhje të kësaj problematike.

- Koordinimi i punëve me Qendrën për Strehim kolektiv-Lagjja Kuvajtjane.
- Zhvillimi dhe avancimi i bashkëpunimit të ndërsjell me autoritetin Shëndetësor të Qarkut Ministrinë e Shëndetësisë, institutin kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe me të gjitha institucionet qeveritare e joqeveritare, vendore e ndërkombëtare.

Objektivat

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore
- Rregullimi i infrastrukturës shëndetësore
- Furnizimi me pajisje bashkëhore mjekësore
- Furnizim të mjaftueshëm me barna

Buxheti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	3,103,515	3,225,417	3,352,146
2	Mallra dhe shërbime	787,000	1,057,000	1,065,000
3	Shpenzime komunale	105,600	105,600	105,600
4	Subvencione	250,000	250,000	250,000
5	Investime kapitale	170,000	290,000	290,000
	Gjithsej:	4,646,115	4,928,017	5,062,746

	Stafi	310	310	310
--	-------	-----	-----	-----

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

- Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit planifikon zhvillimin hapësinor dhe urbanistik, përcjell dhe studion zhvillimin hapësinor brenda territorit të komunës (sipas metodologjisë bashkëkohore);
- Harton programe, planin zhvillimor të komunës, planin zhvillimor urban, dhe planet rregulluese urbane të vendbanimeve dhe tërësive tjera;
- Ofron sugjerime dhe mendime lidhur me procedurën për miratimin e tyre dhe propozon realizimin e tyre;
- Mbledh, përpunon dhe plotëson dokumentacionin e zhvillimit hapësinor, në harmoni me Ligjin për planifikimin hapësinor dhe dispozitat tjera të nxjerra në bazë të tij;
- Bashkëpunon me të gjitha subjektet pjesëmarrëse në planifikimin dhe zhvillimin e qytetit dhe të komunës për hartimin e planeve hapësinore;
- Merret me planifikimin urban dhe rural të komunës dhe të shfrytëzimit të tokës;
- Bashkëpunon rreth konceptit të zgjidhjeve dhe përmbajtjeve të planeve rregulluese urbane;
- Përcjell planifikimin urbanistik dhe projektimin dhe merret me zbatimin e tyre;
- Përgatit plane të detajuara urbanistike, projektet urbanistiko-arkitektonike për lagje dhe tërësi të caktuara të qytetit dhe komunës;
- Angazhohet për zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor, si dhe zvogëlimin ose ndalimin e atyre aspekteve ekonomike dhe të aktiviteteve të tjera që përbëjnë rrezik të madh për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;
- Bën mbrojtjen e biodiversitetit, duke tentuar arritjen e bilancit ekologjik në territorin e komunës dhe më gjerë;
- Bën mbikëqyrjen për shfrytëzimin racional dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të tokës prodhuese, si dhe mbrojtjen e akumulimeve gjenetike të natyrës;
- Harton programin dhe bën mbikëqyrjen e pamjeve të vlefshme të natyrës, propozon zonat e reja për mbrojtje, mbron dhe bën rehabilitimin e diversitetit dhe vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit;
- Kryen edhe detyra të tjera në pajtim me dispozitat ligjore.
- Projektet dhe politikat urbane janë në harmoni me komponentën gjinore;

Objektivat

- Zhvillimi i vazhdueshëm i urbanizimit
- Përmisimi i infrastrukturës rrugore
- Përmisimi i ambientit

Buxheti për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	157,575	163,878	170,434
2	Mallra dhe shërbime	190,000	140,000	130,000
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			

5	Investime kapitale	2,462,000	2,820,000	3,085,000
	Gjithsej:	2,809,575	3,123,878	3,385,434

	Stafi	15	15	15
--	--------------	----	----	----

Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë

Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi bënë matjen dhe kadastrin e tokave

- Përtërirjen e matjes dhe kadastrit të tokave.
- Punët e gjeodezisë për nevoja të posaçme.
- Kadastrin përques dhe objekteve nëntokësore.
- Përcaktimin e punëve lidhur me arondimin dhe kamasacionin e tokave.
- Evidentimin e pasurisë së patundshme dhe përcaktimin e të hyrave kadastrale
- Mbajtjen e arkivit teknik-originalitetin e planeve dhe hartave të punës themelore të gjeodezisë dhe shënimeve tjera. Jep shënime mbi pronarët ,shfrytëzuesit dhe të atyre që gëzojnë të drejtat e tokave, mbi sipërfaqet dhe të hyrat kadastrale, si dhe punë të tjera lidhur me mirëmbajtjen e matjeve dhe të kadastrit të tokave.
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe vendime të Kuvendit.
- Mbrojtjen, ruajtjen dhe evidentimin e patundshmërisë së Komunës.
- Qeverisjen, shfrytëzimin dhe disponimin e patundshmërisë.
- Eksproprijimin,deeksproprijimin, arondimin dhe format tjera të pronësisë. Qarkullimin e tokës ndërtimore, shitblerjen e banesave dhe shtëpive.
- Drejtoria është e organizuar në dy sektorë: Sektori i Pronës dhe Kadastrit

Buxheti i Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	171,793	178,665	185,817
2	Mallra dhe shërbime	10,000		
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	181,793	178,665	185,817

	Stafi	18	18	18
--	--------------	----	----	----

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Organizmi i jetës kulturore dhe krijimi i kushteve për zhvillimin e kulturës rinisë dhe sportit. Krijimi dhe mbështetja e subjekteve dhe individëve krijues të fushave të ndryshme, aktiviteteve rinore dhe sportive në nivel të Komunës. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm vlerash konkurruese. Gjetja e hapësirave të reja shprehëse dhe mbështetëse për zhvillimin e proklamuar të kulturës, aktiviteteve rinore dhe sportive.

- Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do ofron mundësi të barabarta vajzave dhe djemëve për ushtrimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive.

Objektivat:

- Rritja e aktiviteteve sportive dhe kulturore
- Renovimi i objekteve të trashigimisë kulturore
- Ndërtimi i tereneve sportive
- Ndërtimi i shtëpisë së kulturës

Buxheti i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	301,537	313,600	326,145
2	Mallra dhe shërbime	70,000	75,000	80,000
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione	195,000	245,000	295,000
5	Investime kapitale	200,000	200,000	100,000
	Gjithsej:	766,537	833,600	801,145

	Stafi	29	29	29
--	--------------	----	----	----

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

- Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ofron mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë: furnizimin me ujë, kanalizimin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave dhe skemave të nxehjes lokale.
 - Sigurimi dhe mirëmbajtja e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave;
 - Menaxhimi i investimeve kapitale në infrastrukturën publike, sidomos të kanalizimit fekal dhe atmosferik, urave, rregullimit të rrugëve me zhavorr, trotuareve, meremetimin e rrugëve të asfaltuara, etj.
 - Komunat do t'i rregullojnë shërbimet e ujit sipas marrëveshjeve mbi shërbimet të përcaktuara me rregullore.
 - Mbikëqyrë mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues të ujësjellësit.
 - Bashkëpunon me kompanitë publike për caktimin e çmimeve për shërbime komunale.
 - Angazhohet për gjetjen e donatoreve për realizimin e projekteve të natyrës së njëjtë.
 - Cakton prioritetet për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit ekzistues të ujësjellësit.
 - Ndërtimin e sistemeve të reja të kanalizimit si dhe rrjeteve të reja të ujësjellësit.
 - Pastrimin, larjen dhe largimin e borës dhe akullit nga rrugët, sheshet dhe trotualet.
 - Përcjell funksionimin e tregjeve komunale.
 - Kujdeset për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta.
 - Kujdeset për mirëmbajtjen e rrugëve në Komunë.
 - Hartimin e planit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
 - Vlerësimin e rrezikshmërisë, duke u bazuar në të dhënat faktike për planifikim, ndërmarrjen e masave parandaluese për pengimin, zvogëlimin dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë elementare.
 - Propozon formimin e njësive për mbrojtje dhe shpëtim, kryen plotësimin e tyre me obligues dhe i kompletton ato me mjete adekuate për veprim, në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.
 - Harton Planin e vlerësimit të rreziqeve në Komunë.
 - Përgatitjen e programeve për aftësim të sferës së mbrojtjes dhe shpëtimit.
 - Kujdeset për sigurimin dhe mirëmbajtjen e rezervave të mjeteve materiale, në rast fatkeqësie.
 - Organizimin e funksionimit të sistemit të vështrimit, lajmërimit dhe alarmimit.
 - Organizimin e mbrojtjes nga zjarri, kujdeset për zbatimin dhe avancimin e masave mbrojtëse kundër zjarrit.
 - Komuna është përgjegjëse për transportin lokal brenda territorit të vet, në pajtim me Ligjin 2004/1 mbi transportin rrugor dhe do të ushtrojë pushtetin e vet dhe përgjegjësitë në pajtim me këtë ligj.
 - Koordinon aktivitetin mbi transportin publik të mallrave dhe udhëtarëve, me kompanitë publike dhe shoqatat e taksistëve.
 - Cakton linjat për bartjen e udhëtarëve në trafikun urban.
 - Jep pëlqimin për regjistrimin e veprimtarisë së taksistëve, sipas rregullorës së komunikacionit.
 - Bën shpalljen e ankandeve publike për automjetet e konfiskuara, të cilat nuk tërhiqen në afatin e caktuar nga pronarët.
 - Bashkëpunon dhe koordinon punën me Policinë e Kosovës për rregullimin e transportit lokal.
 - Cakton rrugët për të gjitha llojet dhe për automjetet (taksi, autobus, parkingje të limituara)
 - Përkujset për shenjëzimin horizontal dhe vertikal të rrugëve.
-

- Mbylljen e rrugëve në rast nevojë (gjatë festave shtetërore, manifestimeve, garave sportive, etj.).
- Përgjegës për ndriqimin publik, tabelat reklamuese, reklamat ndriqese të firmave dhe reklamat.
- Merr pjesë në mbikëqyrjen e punimeve dhe propozon anëtarë për komisionet e pranimit teknik të punëve të kryera-ndriqimi publik,
- Menaxhimin dhe kontrollimin e shesheve, që i përkasin komunës.
- Në realizimin e projekteve dhe politikave gjithmonë është në përputhje me komponentën gjinore, duke ofruar barazi për dy gjinitë

Objektivat:

- Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike
- Ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve
- Rregullimin e shtretërve të lumejëve
- Zbatimin e planit të mobilitetit urban
- Ndërtimin e trotuarëve
- Ndërtimin e ndriçimit publik në çdo lagje dhe fshat

Buxheti për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	353,018	367,139	381,825
2	Mallra dhe shërbime	1,155,000	1,283,050	1,320,000
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione	130,000	130,000	130,000
5	Investime kapitale	2,325,000	2,710,000	2,060,000
	Gjithsej:	3,768,720	4,288,119	3,891,825
	Stafi	31	31	31

Drejtoria e Inspekcionit

- Mbikëqyrë dhe inspekton të gjitha dukuritë negative që hasen në territorin e Komunës së Podujevës;
- Mbikëqyrë dhe verifikon nëse shtetasit në administrim të pasurisë së tyre, zbatojnë ose plotësojnë kërkesat e akteve komunale;
- Të ndalojë uzurpimin e paligjshëm të trojeve, ndërtesave dhe objekteve të komunës si dhe të organizojë lirimin e tyre;
- Përcjellë procesin e ndërtimeve, ndryshimeve, shndërrimeve, si dhe rrënimit të objekteve;

- Inspekton dokumentacionin teknik (projektet e ndërtimit, lejet e ndërtimit, inspektimin final të vendndërtimit);
- Inspekton procesin e ndërtimit në të gjitha fazat dhe verifikon përputhshmërinë me dokumentacionin ndërtimor;
- Sigurohet që janë ndërmarrë masat adekuate të sigurisë së objekteve në ndërtim, objekteve të tjera përreth dhe komunikacionit;
- Në punën e Drejtorisë gjithmonë merret parasysh komponenta gjinore

Buxheti për Inspektion

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	218,091	226,815	235,888
2	Mallra dhe shërbime	55,000	55,000	55,000
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	273,091	281,815	290,888

	Stafi	17	17	17
--	--------------	----	----	----

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

- Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural përcjell dhe zbaton politika zhvillimore të bujqësisë dhe zhvillimit, koordinon dhe mbikëqyrë punët në bujqësi dhe shoqatat e fermerëve.
- Përgatit planet vjetore të zhvillimit dhe të prodhimit si dhe përcjell realizimin e këtyre planeve.
- Përgatit raporte dhe informata lidhur me prodhimtarinë bujqësore siç janë : Mbjelljet pranverore, mbjelljet vjeshtore korret dhe realizimi i të gjitha të mirave bujqësore.
- Përcjell zhvillimet dhe krijon pasqyra tabelore statistikore si dhe mban evidencën e të arriturave shkencore në prodhimtarinë e bujqësisë si dhe udhëheq evidencën mbi numrin e bagëtive sipas llojit .
- Përcjell vëllimin fizik të prodhimit sipas degëve në bujqësi .
- Përcjell dhe merr pjesë në realizimin e planeve vjetore dhe afate mesme të zhvillimit të blegtorisë dhe lavërtarisë si dhe përgatit analiza dhe informata.
- Përcjell dhe punon në ngritjen e minifermave të reja.
- Propozon dhe përcjell realizimin e programit të mbrojtjes shëndetësore të bagëtive dhe propozon masa veterinare sanitare për mbrojtjen e tyre nga sëmundjet e ndryshme.
- Zbaton rregullativën ligjore nga lëmi e bujqësisë si dhe propozon vendime dhe rregullore bordit të drejtorëve dhe Kuvendit të Komunës për miratim.

- Përcjell dhe merr pjesë në hartimin e planeve dhe programeve për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve në territorin e Komunës .
- Propozon dhe harton plane për ripyllëzim .
- Në punët e Drejtorisë gjithëmon merret parasysh komponenta gjinore, duke ofruar barazi për dy gjinitë

Objektivat:

- Subvencionimi i bujqëve
- Rritja e prodhimit bujqësor
- Rritja e punësimit në sektorin e bujqësisë

Buxheti për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	82,524	88,945	92,503
2	Mallra dhe shërbime	30,000	30,000	30,000
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione	700,000	750,000	750,000
5	Investime kapitale	600,000	800,000	1,100,000
	Gjithsej:	1,412,524	1,668,945	1,972,503

	Stafi	8	8	8
--	--------------	---	---	---

Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik

Koordinon, përgatit dhe harton Strategjinë zhvillimore dhe plane e projekte të veçanta për krijimin e një kornize të përshtatshme për zhvillim të qëndrueshëm të Komunës duke marrë për bazë nevojat e grave dhe burrave.

Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Ministritë, institucionet tjera relevante dhe grupet e veçanta të interesit, identifikon mundësitë zhvillimore dhe propozon programet prioritare si dhe masat për realizimin e tyre.

- Përcjellë ecuritë ekonomike sipas sektorëve në përgjithësi dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në veçanti.
- Grumbullon dhe përpunon të dhëna statistikore për bizneset, resurset njerëzore dhe natyrore me rëndësi për hartimin e informacioneve, analizave planeve dhe programeve për zhvillim të Komunës.
- Përcjellë tregun e punës, identifikon nevojat dhe propozon masa për harmonizimin e ofertës dhe kërkesës në lëmi të caktuara.

- Bënë promovimin e resurseve zhvillimore të Komunës përmes buletineve, panairove dhe organizimeve tjera.
- Hulumton dhe identifikon projektet dhe koordinon punët rreth partneritetit publiko privat.
- Mban kontakte me donatorë, komunitetin e biznesit dhe bashkatdhetarët që jetojnë në botën e jashtme për krijimin e kushteve për investime në Komunë.
- Ofron këshilla, organizon programe trajnuese dhe rikualifikuese si dhe asistencë teknike për bizneset e reja.
- Bënë regjistrimin, ndryshimin e veprimtarisë dhe çregjistrimin e bizneseve dhe mban data bazë për numrin, strukturën dhe selinë e bizneseve.
- Zbaton politikat e përcaktuara dhe aktet normative nga fushëveprimtaria e Komunës në lëmin e zhvillimit dhe planifikimit.
- Harton propozime të akteve të përgjithshme normative nga fushëveprimtaria e Drejtorisë.
- Bashkëpunon dhe koordinon punët dhe aktivitetet me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.
- Kryen edhe punë tjera të caktuara nga Kuvendi dhe Kryetari i Komunës.
- Drejtoria propovon dhe trajton në menyrë të barabartë të dy gjinitë

Objektivat:

- Përmisimi i ambientit i të bërit biznes
- Ndërtimi i Parkut Industrial
- Mbështetja e biznesit përmes subvencioneve
- Themelimi i Inkubatorit të Biznesit


Buxheti për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik

NR.	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	92,680	96,388	100,244
2	Mallra dhe shërbime:	40,000	50,000	50,000
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione	300,000	350,000	350,000
5	Investime kapitale	250,000	100,000	900,000
	Gjithsej:	682,680	596,388	1,400,244

	Stafi	9	9	9
--	--------------	----------	----------	----------

Tabela : Korniza Buxhetore Komunale, në euro

Përsëkrimi 2020 (aktual)	2023 (aktual)	2024 (aktual)	2024 (aktual)	2026 (plan)	2027 (vlerësimet)	2028 (vlerësimet)
TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	27,406,566	31,423,020	33,459,115	34,778,954	36,640,812	38,453,975
Të hyrat vetanake	1,806,493	1,859,659	1,986,336	2,358,325	2,518,647	2,527,090
Grantet dhe transferet qeveritare	25,600,073	29,563,361	31,472,779	34,420,629	34,122,165	35,926,885
SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	27,406,566	31,423,020	33,459,115	34,778,954	36,640,812	38,453,975
Shpenzimet rrjedhëse	18,126,585	22,056,265	24,326,692	26,021,954	27,240,812	28,238,975
Pagat dhe mëditjet	12,969,636	16,287,764	17,793,060	19,928,342	20,722,162	21,544,572
Mallrat dhe shërbimet	3,556,899	4,118,501	4,723,632	4,398,612	4,873,650	4,999,403
Subvencionet	1,600,050	1,650,000	1,810,000	1,695,000	1,845,000	1,895,000
Shpenzimet Kapitale	9,279,981	9,366,755	9,132,423	8,757,000	9,200,000	10,015,000



Projeksionet e shpenzimeve të buxhetit komunal sipas Limitit të parë buxhetor të arritur nga MF-i

Nga MF-i, me dt. 15.05.2025 kanë arritur limitet e para buxhetore për Komunitat për periudhën 2026-2028. Granti fillestarë i Qeverisë për Komunitat e Podujevës është si vijon:

Limiti fillestar	Grand.përgj	Grand.arsim	Grant.Shëndet.	Gjiths.Granti komunal
2026-Limiti. fillestar	14,812,998	13,690,040	3,917,591	32,420,629
2027-Limit indikativ	15,823,206	14,100,741	4,918,218	34,122,165
2028-Limit indikativ	17,090,956	14,523,764	4,312,165	35,926,885

Projeksionet e shpenzimeve të buxhetit komunal për vitet 2026-2028, sipas Programeve buxhetore dhe në bazë të Limiteve të para Buxhetore të caktuara nga ana e Komisionit të Grandeve të MF-it, janë si vijon:

Projeksioni i të hyrave Buxhetore 2026-2028 të Komunitat së Podujevës

KK-Podujevë	Buxheti - 2026	Buxheti - 2027	Buxheti – 2028
Të hyrat nga.Granti i Qeverisë	32,420,629	34,122,165	35,926,885
Të hyrat vetanake	2,358,325	2,518,647	2,527,090
TOTALI:	34,778,954	36,640,812	38,453,975

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2026-2028 SIPAS LIMITIT TË PARË

KK-Podujevë	Buxheti – 2026	Buxheti - 2027	Buxheti - 2028
Paga dhe mëditje	19,928,342	20,722,162	21,544,572
Mallra dhe shërbime	3,704,000	4,163,050	4,288,803
Komunali	694,612	710,600	710,600
Subvencione	1,695,000	1,845,000	1,895,000
Investime kapitale	8,757,000	9,200,000	10,015,000
TOTALI:	34,778,954	36,640,812	38,453,975
Grandi i Qeverisë	32,420,629	34,122,165	35,926,885
Të Hyrat vetanake	2,358,325	2,518,647	2,527,090
TOTALI:	34,778,954	36,640,812	38,453,975

Mallrat dhe shërbimet 2026-2028

Pozicionet buxhetore		VITI 2026	VITI 2027	VITI 2028
BUXHETI I ADMINISTRATËS				
	MALLRA DHE SHËRBIME-ADMINISTRATE	252,000.00	278,000.00	273,803.00
1	Pajisje të IT	15,000.00	15,000.00	15,000.00
2	Furnizim me inventar(mobilje)	15,000.00	10,000.00	10,000.00
3	Furnizim për zyre	30,000.00	30,000.00	30,000.00
4	Furnizim me material higjenik	20,000.00	26,000.00	26,000.00
5	Derivate për vetura	30,000.00	30,000.00	30,000.00
6	Naftë për ngrohje	20,000.00	20,000.00	20,000.00
7	Regjistrimi i automjeteve	12,000.00	12,000.00	12,000.00
8	Mirëmbajtja e automjeteve	25,000.00	25,000.00	25,000.00
9	Mirembajtja e objekteve komunale	30,000.00	30,000.00	25,000.00
10	Shërbime Kontraktuese	55,000.00	80,000.00	80,803.00
	SHPENZIME KOMUNALE-ADMINISTRATA	452,012.00	468,000.00	468,000.00

1	Rryma	405,012.00	420,000.00	420,000.00
2	Uje	28,000.00	29,000.00	29,000.00
3	Telefon	3,000.00	3,000.00	3,000.00
4	Mbeturina	16,000.00	16,000.00	16,000.00
	KUVENDI KOMUNAL			
	Mallra dhe shërbime-Kuvendi Komunal	20,000	25,000	25,000
1	Sherbime Kontraktuese	20,000	25,000	25,000
	DREJTORIA E PRONËS			
	Mallra dhe shërbime – PRONË	10,000.00		
1	Furnizim me pajisje	10,000.00		
	Drejtoria e Urbanizmit			
	Mallra dhe shërbime - URBANIZËM	190,000.00	140,000.00	130,000.00
1	Hartimi i hartës zonale	90,000.00		
2	Hartimi i planeve rregulluese urbane te hollesishme	50,000	80,000	70,000
3	Hartimi i projekteve	50,000	60,000	60,000
	Drejtoria e Shërbimeve Publike			
	Mallra dhe shërbime – SHËRBIME PUBLIKE	1,155,000.00	1,283,050.00	1,320,000.00
1	Mirëmbajtja dimerore e rrugëve	120,000.00	120,000.00	120,000.00
2	Mirëmbajtja verore e rrugëve	230,000.00	300,000.00	330,000.00
3	Mirëmbajtja e ndriçimit publik	170,000.00	175,000.00	180,000.00
4	Mirëmbajtja e lumenjve	150,000.00	150,000.00	160,000.00
5	Mirëmbajtja dhe furnizimi me kamera	30,000.00	30,000.00	30,000.00

6	Sherbime kontraktuese	190,000.00	198,050.00	190,000.00
7	Mirëmbajtja e trotuareve	50,000.00	45,000.00	40,000.00
8	Furnizimi me drunje dekorativ	200,000.00	250,000.00	250,000.00
9	Furnizimi me lule	15,000.00	15,000.00	20,000.00
	Subvencione - SHËRBIME PUBLIKE	130,000.00	130,000.00	130,000.00
1	Subvencione për etnitete – jo publike	130,000.00	130,000.00	130,000.00
	DREJTORIA E SHËNDETËSISË			
	Mallra dhe shërbime - SHËNDETËSI	787,000.00	857,000.00	865,000.00
1	Furnizime me barna dhe reagensa	500,000.00	550,000.00	558,000.00
2	Servisimi i pajisjeve mjekësore	40,000.00	40,000.00	40,000.00
3	Furnizim me pajisje	15,000.00	20,000.00	20,000.00
4	Furnizim me dokumentacion mjekësor	30,000.00	30,000.00	30,000.00
5	Furnizim me material higjenik	25,000.00	25,000.00	25,000.00
6	Furnizim me pelet	25,000.00	25,000.00	25,000.00
7	Furnizim me naftë për ngrohje	15,000.00	15,000.00	15,000.00
8	Furnizim me naftë për vetura (shërbimi shtëpika shëndetsor dhe paliativ)	40,000.00	40,000.00	40,000.00
9	Furnizimi dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit	5,000.00	5,000.00	5,000.00
10	Furnizim me oksigjen	7,000.00	7,000.00	7,000.00
11	Shërbime kontraktuese	30,000.00	40,000.00	40,000.00
12	Furnizim me inventar	20,000.00	20,000.00	20,000.00
13	Mirembajtja e objekteve	35,000.00	40,000.00	40,000.00
	KOMUNALI - SHËNDETËSI	105,600.00	105,600.00	105,600.00
1	Rryma	83,000.00	83,000.00	83,000.00
2	Ujë	15,000.00	15,000.00	15,000.00
3	Telefoni	1,600.00	1,600.00	1,600.00
4	Mbeturina	6,000.00	6,000.00	6,000.00

	Subvencione - Administrata e Shëndetësisë	250,000.00	250,000.00	250,000.00
1	Subvencione	250,000.00	250,000.00	250,000.00
	SHËRBIME REZIDENCIALE			
	Mallra dhe shërbime – Shërbime Rezidenciale		200,000.00	200,000.00
1	Blerja e mallrave		100,000.00	100,000.00
2	Shërbime kontraktuese		100,000.00	100,000.00
	KOMUNALI - Shërbime Rezidenciale			
	Mallra dhe shërbime - ARSIM	1,095,000.00	1,170,000.00	1,260,000.00
1	Shërbime kontraktuese	115,000.00	150,000.00	150,000.00
2	Furnizim me inventar (mobilje)	140,000.00	100,000.00	120,000.00
3	Shujta për nxënësit	300,000.00	310,000.00	360,000.00
4	Lëndë djegëse	220,000.00	190,000.00	190,000.00
5	Pajisje tjera(Furnizim me kabinete)	85,000.00	150,000.00	160,000.00
6	Blerja e mallrave	85,000.00	120,000.00	130,000.00
7	Mirëmbajtja e shkollave	100,000.00	100,000.00	100,000.00
8	Platforma digjitale e Arsimit	50,000.00	50,000.00	50,000.00
	KOMUNALI - Arsim	137,000.00	137,000.00	137,000.00
1	Rryma	72,000.00	72,000.00	72,000.00
2	Ujë	32,000.00	32,000.00	32,000.00

3	Telefoni	8,000.00	8,000.00	8,000.00
4	Mbeturina	25,000.00	25,000.00	25,000.00
	Subvencione - Arsim	120,000.00	120,000.00	120,000.00
1	Bursa pr student	120,000.00	120,000.00	120,000.00
	DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK			
	Mallra dhe shërbime-Zhvillim Ekonomik	40,000.00	50,000.00	50,000.00
1	Shërbime kontraktuese	40,000.00	50,000.00	50,000.00
	Subvencione - Zhvillim Ekonomik	300,000.00	350,000.00	350,000.00
1	Subvencione për biznese dhe ndërmarrje publike	300,000.00	350,000.00	350,000.00
	DREJTORIA E KULTURËS			
	Mallra dhe shërbime -KULTURË	70,000.00	75,000.00	80,000.00
1	Furnizim me libra shkencore per bibloteke	30,000.00	30,000.00	30,000.00
2	Shërbime kontraktuese	40,000.00	45,000.00	50,000.00
	Subvencione – Kulturë	195,000.00	245,000.00	295,000.00
1	Subvencione për kulturë dhe sport	150,000.00	200,000.00	250,000.00
2	Subvencione për teatër	45,000.00	45,000.00	45,000.00
	DREJTORIA E INSPEKSIONIT			
	Mallra dhe shërbime - INSPEKSION	55,000.00	55,000.00	55,000.00
1	Rrenimi dhe largimi i objekteve	45,000.00	45,000.00	45,000.00
2	Blerja e mallrave	10,000.00	10,000.00	10,000.00
	DREJTORIA E BUJQËSISË			
	Mallra dhe shërbime-Bujqësia	30,000.00	30,000.00	30,000.00

1	Hartimi i projektit te ujitjes se tokave bujqesore	30,000.00	30,000.00	30,000.00
	Subvencione - Bujqësi	700,000.00	750,000.00	750,000.00
1	Subvencione për perimkultur	200,000.00	200,000.00	200,000.00
2	Subvencione për bletari	50,000.00	50,000.00	50,000.00
3	Subvencione për blegtori	250,000.00	250,000.00	250,000.00
4	Subvencione për mekanizëm bujqësor	120,000.00	170,000.00	170,000.00
5	Subvencione për pemtari	40,000.00	40,000.00	40,000.00
6	Subvencione për shpeztari	40,000.00	40,000.00	40,000.00

Programi komunal i investimeve publike (PIP)

Programi komunal për Investime publike përfshinë të gjitha projektet e aprovuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitet 2026-2028 nga ana e Kuvendit të Komunës së Podujevës sipas proceseve buxhetore të zhvilluara gjatë vitit 2025. Projektet janë bazuar edhe nga nevojat e paraqitura të grave, burrave dhe grupeve në nevojë.

Në tabelën e mëposhtme po paraqesim Listën e projekteve kapitale të parapara me Buxhetin e vitit 2026 , 2027 dhe 2028 të parapara nga grandit dhe të hyrat vetanake. Kjo listë mund të modifikohet me propozime të reja që do të vinë nga Drejtoritë gjatë këtij shqyrtimi-punëtorie me Drejtorët e Drejtorive dhe strukturat tjera udhëheqëse dhe organeve relevante komunale për hartimin e politikave zhvillimore të Komunës duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara për financim si dhe aftësive dhe burimeve të ardhurave komunale , si dhe Grandet e Qeverisë dhe Donatorët e ndryshëm.

Duhet të theksojmë se arsyetimet e dhëna për projektet që pritet të financohen gjatë vitit fiskal 2025 nga të hyrat vetanake si dhe ato të dërguara në MF-ë për financim eventual nga donatorët gjatë muajit dhjetor 2025, janë vlerësuar mjaft mirë nga kompetentet për përcjelljen e projekteve.

Përshkrimi i projekteve prioritare për vitin 2026

Drejtoria për Urbanizëm

	Emërtimi i projektit	Shuma e projektit
	Buxhetit Total	2,462,000.00
1	Ndërtimi i rrugës nga stacioni i autobusëve deri në rrugën e re lidhëse në qytet	150,000.00
2	Ndërtimi i rrugës nga magjistranja deri në rrugën Bedri Ahmeti	200,000.00
3	Ndërtimi i rruges 19 Qershori	200,000.00
4	Rregullimi i hapësirave publike në qytet	300,000.00
5	Asfaltimi rrugëve në qytet	200,000.00
6	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Orllan me rrethinë	80,000.00
7	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Balloc	20,000.00
8	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bellopojë	25,000.00
9	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lupç	20,000.00
10	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Letanc	30,000.00
11	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gërdoc	30,000.00
12	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumnicë	40,000.00
13	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Repë	20,000.00
14	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bradash	30,000.00
15	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Pakashticë	20,000.00
16	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bajqinë	20,000.00
17	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Siboc	30,000.00
18	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Zakut	25,000.00
19	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Obrançë	20,000.00
20	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Metehi	25,000.00
21	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shtedim	20,000.00
22	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shakovicë	20,000.00
23	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Surkish	25,000.00
24	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gllamnik	35,000.00

25	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Miroc	28,000.00
26	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Batllavë	40,000.00
27	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Buricë	25,000.00
28	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dobratin	30,000.00
29	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumosh	30,000.00
30	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dyz	25,000.00
31	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dvorishtë	20,000.00
32	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Halabak	25,000.00
33	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Herticë	25,000.00
34	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Llapashticë	50,000.00
35	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lluzhan	20,000.00
36	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Majac	20,000.00
37	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Peran	25,000.00
38	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sylevicë	30,000.00
39	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shajkoc	24,000.00
40	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Tërrenavë	30,000.00
41	Asfaltimi i rruges ne fshatin Rakinice	30,000.00
42	Asfaltimi i rrugeve në Doberdol	30,000.00
43	Asfaltimi i rrugeve në Penuhë	30,000.00
44	Asfaltimi i rrugeve ne Pollate	20,000.00
45	Asfaltimi i rrugeve ne Popovë	20,000.00
46	Asfaltimi i rrugëve në Kaqybeg	20,000.00
47	Asfaltimi i rrugëve në Kërpimeh	30,000.00
48	Asfaltimi i rrugëve në Konushec	25,000.00
49	Asfaltimi i rrugëve në Livadicë	20,000.00
50	Asfaltimi i rrugëve në Lladoc	20,000.00
51	Asfaltimi i rrugëve në Llaushë	25,000.00
52	Asfaltimi i rrugëve në Lluga	20,000.00
53	Asfaltimi i rrugëve në Revuq	30,000.00
54	Asfaltimi i rrugëve në Sallabajë	30,000.00
55	Asfaltimi i rrugëve ne Sfeqël	30,000.00
56	Asfaltimi i rrugeve ne Katunisht	30,000.00
57	Asfaltimi i rrugeve në Zhiti	20,000.00

16305-Drejtoria e Administrates

	Emërtimi i projektit	Shuma e projektit
	Buxhetit Total	220,000.00
1	Ndërtimi I aneksit të komunes	220,000.00

18165- Infrastruktur Publike

	Emërtimi i projektit	Shuma e projektit
	Buxhetit Total	2,325,000.00
1	Ndërtimi i trotuareve ne qytet dhe fshatra	80,000.00
2	Zgjerimi,rregullimi i shtratit të lumit Llap	100,000.00
3	Shenjzimet horizontale dhe vertikale	140,000.00
4	Ndriqimi publik ne fshatrat dhe qytet	70,000.00
5	Kanalizimi nga fshati Lluzhan-Lupq, Gerdac-Lluzhan(Kolektori)	1,000,000.00
6	Rregullimi i rrugeve me zhavor	200,000.00
7	Ndërtimi i kalesave,urave të vogla	85,000.00
8	Ndërtimi i rrugeve me elemente betoni (ndërtimi i rrugeve me kubza betoni , ndërtimi i kalesave te vogela ne trotuare , ndërtimi i urave të vogla per kembesore etj) ne fshatra dhe qytet	150,000.00
9	Rregullimi i infrastruktures se varrezave	200,000.00
10	Rindërtimi i rrugeve	300,000.00
11		

75522-Sherbime Rezidenciale

	Emërtimi i projektit	Shuma e projektit
	Buxheti Total	230,000.00
1	Ndërtimi i shtepise per persona me aftesi te kufizuara	230,000.00

73300- Shendetesia

	Emërtimi i projektit	Shuma e projektit
	Buxheti Total	170,000.00
1	Pajisje mjekësore për QKMF	80,000.00
2	Blerja e autoambulancës	60,000.00
3	Renovimi i objekteve shendetesore	30,000.00

Drejtoria e Arsimit

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	2,300,000.00
1	"Ndërtimi i një objekti të shkollës së Mesme të kampusi i shkollave të mesme"	450,000.00
2	Ndërtimi I aneksit të shkolles "Ibrahim Rugova"	200,000.00
3	Ndërtimi I aneksit të shkolles "Enver Maloku"	200,000.00
4	Ndërtimi I aneksit të shkolles "Xheladin Rekaliu"	200,000.00
5	Tabela Digjitale	150,000.00
6	Renovimi I institucioneve arsimore	200,000.00
7	Ndërtimi I shkollës Nuhi Gashi në Bradash	300,000.00
8	Ndërtimi I shkollës Jetullah Gashi në Dobërdol	300,000.00
9	Ndërtimi i kuzhinës qenderore	300,000.00

48005- Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	300,000.00
1	Ndërtimi i Zonës Industriale në Livadicë	150,000.00
2	Ngritja e infrastruktures se turizmit	100,000.00
3	Ndërtimi i tregut te kafsheve	50,000.00

85005- Kultura

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	200,000.00
1	Ndërtimi i tereneve sportive në qytet	100,000.00
2	Renovimi i objekteve të trashigimisë kulturore	100,000.00

47005- Bujqësia

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	600,000.00
1	Ndërtimi i Parkut Industrial Bujqësor në Sfeqël	400,000.00
2	Ndërtimi sistemit të ujitjes se tokave bujqesore	200,000.00

Projektet prioritare për vitin 2027**66030- Drejtoria për Urbanizëm**

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	2,820,000.00

1	Ndërtimi I rrugës Bajram Krasniqi	300,000.00
2	Ndërtimi I rrugës Besnik Restelica	200,000.00
3	Ndërtimi I rrugës Bedri Bajrami	190,000.00
4	Ndërtimi i unazës së qytetit	300,000.00
5	Ndërtimi i rrugës 19 Qershori	100,000.00
6	Rregullimi i hapësirave publike në qytet	400,000.00
7	Asfaltimi rrugëve në qytet	250,000.00
8	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Orllan me rrethinë	60,000.00
9	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Letanc	20,000.00
10	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Obrançë	30,000.00
11	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Surkish	25,000.00
12	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gllamnik	25,000.00
13	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Miroc	20,000.00
14	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Batllavë	50,000.00
15	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Buricë	20,000.00
16	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dobratin	30,000.00
17	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumosh	30,000.00
18	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dyz	30,000.00
19	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Halabak	35,000.00
20	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Herticë	30,000.00
21	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Llapashticë	40,000.00
22	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lluzhan	35,000.00
23	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Majac	30,000.00
24	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Peran	20,000.00
25	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sylevicë	25,000.00
26	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shajkoc	30,000.00
27	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Tërrnavë	25,000.00
28	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Rakinice	30,000.00
29	Asfaltimi i rrugëve në Doberdol	40,000.00
30	Asfaltimi i rrugëve në Penuhë	30,000.00
31	Asfaltimi i rrugëve në Pollate	20,000.00
32	Asfaltimi i rrugëve në Popovë	20,000.00
33	Asfaltimi i rrugëve në Kaqybeg	20,000.00
34	Asfaltimi i rrugëve në Kërpimeh	40,000.00
35	Asfaltimi i rrugëve në Konushë	30,000.00

36	Asfaltimi i rrugëve në Livadicë	20,000.00
37	Asfaltimi i rrugëve në Lladoc	20,000.00
38	Asfaltimi i rrugëve në Llaushë	30,000.00
39	Asfaltimi i rrugëve në Lluga	30,000.00
40	Asfaltimi i rrugëve në Revuq	20,000.00
41	Asfaltimi i rrugëve në Sallabajë	30,000.00
42	Asfaltimi i rrugëve në Sfeqël	35,000.00
43	Asfaltimi i rrugëve në Katunisht	30,000.00
44	Asfaltimi i rrugëve në Zhiti	25,000.00

18165- Infrastruktura publike

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	2,710,000.00
1	Ndërtimi i trotuareve në qytet dhe fshatra	100,000.00
2	Zgjerimi, rregullimi i shtratit të lumit Llap	100,000.00
3	Shenjëzimet horizontale dhe vertikale	130,000.00
4	Ndriqimi publik në fshatrat dhe qytet	80,000.00
5	Kanalizimi nga fshati Lluzhan-Lupq, Gerdoci-Lluzhan (Kolektori)	770,000.00
6	Ndërtimi i kanalizimit në fshatra dhe qytet	280,000.00
7	Rregullimi i rrugëve me zhavor	250,000.00
8	Ndërtimi i kalesave, urave të vogla	100,000.00
9	Ndërtimi i rrugëve me elemente betoni (ndërtimi i rrugëve me kubza betoni , ndërtimi i kalesave të vogla në trotuare , ndërtimi i urave të vogla për kembësorë etj) në fshatra dhe qytet	150,000.00
10	Rregullimi i infrastruktures së varrezave	200,000.00
11	Rindërtimi i rrugëve	550,000.00

73300- Shëndetësia

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	90,000.00

1	Pajisje mjekësore për QKMF	50,000.00
2	Renovimi i objekteve shendetësore	40,000.00

Drejtoria e Arsimit

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	2,280,000.00
1	Ndertimi i aneksit të shkolles "Ibrahim Rugova"	200,000.00
2	Ndertimi i aneksit të shkolles "Enver Maloku"	200,000.00
3	Ndertimi i aneksit të shkolles "Xheladin Rekaliu"	200,000.00
4	Tabela Digjitale	300,000.00
5	Renovimi i institucioneve arsimore	330,000.00
6	Ndertimi i aneksit të shkolles në Sfeqel	200,000.00
7	Ndertimi i shkolles në fshatin Lluzhan	300,000.00
8	Ndertimi i aneksit të shkolles "Deshmoret e Kombit"	300,000.00
9	Ndertimi i aneksit të shkolles në Siboc	100,000.00
10	Ndertimi i aneksit të shkollës në Dobratin	150,000.00

75522-Sherbimet Rezidenciale

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	200,000.00
1	Ndertimi i shtëpisë për personat me aftësi të kufizuar	200,000.00

48005- Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	100,000.00
1	Ngritja e infrastruktures së turizmit	100,000.00

47005- Bujqesia

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	800,000.00
1	Ndërtimi i Parkut Industrial Bujqësor në Sfeqël	300,000.00
	Ndërtimi i sistemit të ujitjes së tokave bujqësore	500,000.00

48005- Kultura

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	200,000.00
1	Ndërtimi i tereneve sportive	100,000.00
2	Renovimi i objekteve të trashigimisë kulturore	100,000.00

Projektet prioritare për vitin 2028

66030 - Drejtoria e Urbanizmit

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	3,085,000.00
1	Ndërtimi i rrugës Besnik Restelica	80,000.00
2	Ndërtimi i rrugës Bedri Bajrami	100,000.00
3	Ndërtimi i unazës së qytetit	1,200,000.00
4	Rregullimi i hapësirave publike në qytet	500,000.00
5	Asfaltimi i rrugëve në qytet	250,000.00
6	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Orllan me rrethinë	60,000.00
7	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Balloc	20,000.00
8	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bellopojë	30,000.00
9	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lupç	25,000.00
10	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gërdoc	30,000.00
11	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumnice	25,000.00
12	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Repë	30,000.00
13	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bradash	25,000.00
14	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Pakashticë	30,000.00
15	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bajqinë	30,000.00

16	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Siboc	30,000.00
17	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Zakut	30,000.00
18	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Metehi	30,000.00
19	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shtedim	30,000.00
20	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shakovicë	30,000.00
21	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dvorishtë	30,000.00
22	Asfaltimi i rrugëve në Doberdol	30,000.00
23	Asfaltimi i rrugëve në Penuhë	40,000.00
24	Asfaltimi i rrugëve në Pollate	20,000.00
25	Asfaltimi i rrugëve në Popovë	20,000.00
26	Asfaltimi i rrugëve në Kaqybeg	30,000.00
27	Asfaltimi i rrugëve në Kërpimëh	40,000.00
28	Asfaltimi i rrugëve në Konushec	30,000.00
29	Asfaltimi i rrugëve në Livadicë	20,000.00
30	Asfaltimi i rrugëve në Lladoc	30,000.00
31	Asfaltimi i rrugëve në Llaushë	30,000.00
32	Asfaltimi i rrugëve në Lluga	30,000.00
33	Asfaltimi i rrugëve në Revuq	40,000.00
34	Asfaltimi i rrugëve në Sallabajë	30,000.00
35	Asfaltimi i rrugëve në Sfeqël	30,000.00
36	Asfaltimi i rrugëve në Katunisht	20,000.00
37	Asfaltimi i rrugëve në Zhiti	30,000.00

18165- Infrastrukturë Publike

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	2,060,000.00

1	Ndërtimi i trotuareve në qytet dhe fshatra	200,000.00
2	Zgjerimi, rregullimi i shtratit të lumit Llap	100,000.00
3	Shenjezimet horizontale dhe vertikale	140,000.00
4	Ndriqimi publik në fshatrat dhe qytet	100,000.00
5	Ndërtimi i kanalizimit në fshatra dhe qytet	470,000.00
6	Rregullimi i rrugëve me zhavor	250,000.00
7	Ndërtimi i kalesave, urave të vogla	100,000.00

8	Ndertimi i rrugeve me elemente betoni (ndërtimi i rrugeve me kubza betoni , ndërtimi i kalesave te vogela ne trotuare , ndertimi i urave të vogla per kembesore etj) ne fshtra dhe qytet	200,000.00
9	Rindertimi i rrugeve	500,000.00
10		

73300- Shëndetësia

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	90,000.00

1	Pajisje mjekësore për QKMF	50,000.00
2	Renovimi i objekteve shendetesore	40,000.00

Drejtoria e Arsimit

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	2,480,000.00
1	Tabela Digjitale	500,000.00
2	Renovimi I institucioneve arsimore	380,000.00
3	Ndertimi I aneksit të shkollës në Kerpimeh	300,000.00
4	Ndertimi I shkolles ne fshatin Lluzhan	500,000.00
5	Ndërtimi I aneksit të shkollës në Gllamnik	200,000.00
6	Ndertimi I salles se edukates fizike në Kërpimeh	300,000.00
	Ndertimi I salles se edukates fizike në Orllan	300,000.00

48005- Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	900,000.00
1	Ngritje e infrastrukturës së turizmit	100,000.00
2	Ndertimi i parkut teknologjik	800,000.00

85005- Kultura

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	100,000.00
1	Renovimi i objekteve të trashigimise kulturore	100,000.00

75522- Sherbimet Rezidenciale

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	200,00.00
1	Ndertimi i shtëpisë për personat me aftësi të kufizuar	200,000.00

47005- Bujqesia

	Emërtimi i projekteve	Shuma e projektit
	Buxheti Total	1,100,00.00
1	Ndertimi i Parkut Industrial Bujqesor ne Sfeqël	400,000.00
2	Ndertimi I sistetimit të ujitjes se tokave bujqesore	700,000.00

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor

Tabela 1. Numri i punëtorve në Organizaten Buxhetore përkatëse
Komuna e Podujevës

Viti	Numri Total i stafit	Numri i stafit që janë Gra	Numri i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje(shuma për gra)	Paga dhe mëditje (shuma për burra)
2025	2045	965	1060	8,458,320.50	9,210,720.50
Planifikimi per 2026	2059	985	1074	8,803,520.50	11,124,821.50
2027	2065	990	1075	8,876,120.00	11,846,042.00
2028	2065	990	1075	8,930,530.00	12,614,042.00

Tabela 2. Planifikimi per vitin 2025 Nivelet e pagave në Organizaten Buxhetore
Emri i Institucionit/Ministritë/Komunës

Niveli i pagave	Numri Total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave ne këtë nivel	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400					
400-600	1861	998	8,711,756.18	863	7,207,985.26
600+	198	118	1,111,500.55	80	638,159.30


Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo të shërbimeve të ofruara nga organizatat buxhetore të drejtorive

Viti	Buxheti total i subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve gra	Numri i përfituesve burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2025	1,810,000	1700	835	865	855,000.00	955,000.00
Planifikimi per 2026	1,695,000	1720	835	885	790,000.00	905,000.00
2027	1,845,000	1790	875	915	880,000.00	965,000.00
2028	1,895,000	1800	880	920	910,000.00	985,000.00

Kryetari:
Shpejtim Bulliqi




Drejtori i Financave:
Fatlum Osmani





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCEVE

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 62.3, 11; 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neneve 17; 38; 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenit 64 paragrafi 4, neneve 14; 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozohet

VENDIM

PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KOD TË RI

Neni 1

Me këtë vendim miratohet shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri buxhetor për projektin "Furnizimi me mekanizëm bujqësor" në vlerë 42,857.00€, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 2

Projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes Komunës dhe përfituesve të subvencionit.

Neni 3

Komuna e Podujevës si bartëse e projektit në vlerë të përgjithshme prej 142,857.00€, financon shumën 100,000.00 € apo 70% të vlerës së projektit të cekur, kurse shuma e përgjithshme e participimit nga ana e përfituesve është në vlerë 42,857.00€ apo 30% e vlerës së projektit.

Neni 4

Projekti sipas nenit 1 të këtij vendimi mbulohet me mjete financiar nga participimi prej 30% të vlerës së përgjithshme nga ana e përfituesve, ndërsa 70% të vlerës së përgjithshme nga Komuna e Podujevës, dhe i njëjti bënë pjesë në kategorinë subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – kodi i programit 47005

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot. 01-400/03-0033535/25
Podujevë, datë; 17.06.2025

Drejtori

Fatlum Osmani





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

INFORMATË PËR AKTIVITETET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI-KKSB PËR VITIN 2024

Bazuar në nenin 9 parag. 1.8 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, KKSB informon për punët dhe aktivitete për vitin 2024

Në informatë janë përfshirë në mënyrë të përmbledhur, takimet e KKSB-së, me tema në fusha të caktuara, të cilat paraqesin objektivat dhe zbatimin e Planit vjetor të punës së Këshillit.

Temat e planifikuara me Planin e punës që janë diskutur gjatë vitit.

Në vitin 2024 KKSB ka mbajtur gjashtë (6) takime.

Përmbledhje e punëve dhe aktiviteteve, si vijon:

Mbledhja e parë urgjente/jashtëzakonshme, mbajtur më 22 janar 2024

Në këtë mbledhje tema kryesore ka qenë;

- Situata e Përgjithshme e Sigurisë në Komunën e Podujevës

Konstatim i Situatës së Sigurisë në Komunën e Podujevës

Nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)

Në takimin e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) të mbajtur në Komunën e Podujevës, u shqyrtua gjendja aktuale e sigurisë në territorin e komunës.

Pas prezantimeve të përfaqësuesve të Policisë së Kosovës, përfaqësuesve të shkollave, komuniteteve lokale, organizatave joqeveritare dhe institucioneve tjera relevante, konstatohet si vijon:

1. Gjendja e përgjithshme e sigurisë në komunë vlerësohet si stabile dhe e qetë. Nuk janë evidentuar incidente serioze që rrezikojnë rendin dhe sigurinë publike.
2. Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar një rënie të lehtë, megjithatë mbetet shqetësuese dhe kërkon angazhim të vazhdueshëm nga të gjitha institucionet relevante për parandalim dhe reagim të shpejtë.
3. Në shkolla është vërejtur përmirësim i disiplinës dhe ulje e rasteve të sjelljeve devijante tek të rinjtë, por nevojitet vazhdimësi në bashkëpunim mes institucioneve arsimore dhe Policisë.
4. Qarkullimi në komunikacion është i menaxhuar mirë, por ka ende raste të pakujdesisë nga ngasësit dhe mungesës së infrastrukturës në disa zona rurale.
5. Raportet ndëretnike dhe ndërkomunitare janë stabile, dhe nuk janë evidentuar raste të tensioneve apo incidenteve me prapavijë etnike.
6. Këshilli vlerëson pozitivisht angazhimin e policisë dhe bashkëpunimin me qytetarët, përmes zbatimit të projektit "Policia në bashkësi" si mjet për rritjen e sigurisë dhe besimit qytetar.

Rekomandime:

Të rritet bashkëpunimi ndërinstitutional për parandalimin e dukurive negative.

Të zhvillohen fushata vetëdijësuese për të rinjtë në shkolla mbi sigurinë dhe sjelljet e rrezikshme.

Të përmirësohet infrastruktura rrugore në fshatra për të garantuar siguri në komunikacion.

Të vazhdohet me takime të rregullta dhe transparente të KKSB-së me përfshirjen aktive të qytetarëve.

-Informatë e Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

-Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-it për sigurinë në komunë

-Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

Konstatim pas Mbledhjes së Dytë të Këshillit për Siguri në Bashkësi – Komuna e Podujevës

Në ambientet e Komunës së Podujevës, u mbajt mbledhja e dytë e rregullt e Këshillit për Siguri në Bashkësi (KKSB). Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësues të Policisë së Kosovës, përfaqësues të KFOR-it, të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), si dhe përfaqësues të institucioneve lokale dhe shoqërisë civile.

Pas prezantimeve dhe diskutimeve të zhvilluara, Këshilli konstaton si vijon:

1. Gjendja e përgjithshme e sigurisë në territorin e Komunës së Podujevës vazhdon të jetë stabile dhe pa incidente madhore.
2. Policia e Kosovës prezantoi të dhëna që tregojnë për një ulje të rasteve penale krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke theksuar angazhimin në patrullime dhe bashkëpunimin me qytetarët për parandalimin e krimit.
3. Përfaqësuesit e KFOR-it vlerësuan lartë bashkëpunimin me institucionet lokale dhe konfirmuan se nuk ka indikacione për ndonjë kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë e përgjithshme në zonë.
4. FSK prezantoi angazhimet e saj në ndihmë të komunitetit, veçanërisht në fushën e menaxhimit të fatkeqësive natyrore dhe trajnimeve për reagim emergjent, duke ofruar gatishmëri për bashkëpunim të mëtejshëm me komunën dhe qytetarët.

5. Përfaqësuesit e institucioneve lokale dhe të shoqërisë civile theksuan rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit qytetar, veçanërisht në parandalimin e dhunës në familje, sigurinë në shkolla dhe në mjedisin rrugor.

Rekomandimet e Këshillit:

Të vazhdohet me takime të rregullta ndërinstitutionale për koordinimin e veprimeve preventive.

Të zhvillohen fushata informuese për qytetarët mbi sigurinë publike dhe reagimin në raste emergjente.

Të rritet bashkëpunimi i shkollave me Policinë dhe institucionet relevante për edukimin e nxënësve mbi rreziqet dhe sjelljet e sigurta.

Të forcohet roli i bashkësive lokale në identifikimin dhe raportimin e shqetësimeve që lidhen me sigurinë.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi falënderoj të gjithë pjesëmarrësit për kontributin dhe mbështetjen në drejtim të garantimit të një ambienti të sigurt dhe të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e komunës.

Mbledhja e tretë, mbajtur më 17 korrik 2024

-Informatë e Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

-Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë

-Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

Këtë mbledhje e udhëhoqi z. Bahri Selimi, përveq informatave që u prezantuan nga përfaqësuesit e institucioneve ku ndër të tjera u diskutua edhe -Informatë nga SHZSH për intervenimet dhe gatishmërinë në rastet kundër zjarreve dhe intervenimet tjera. Po ashtu u diskutua edhe rreth *sigurisë në komunikacion dhe trajtimi i qenve endacak.*

Mbledhja e katërt, mbajtur më 30 shtator 2024

Konstatim përmbledhës nga Mbledhja e Katërt e Këshillit për Siguri në Bashkësi – Komuna e Podujevës

Në Komunën e Podujevës u mbajt mbledhja e katërt e rregullt e Këshillit për Siguri në Bashkësi (KKS), me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Policia e Kosovës, KFOR-i, FSK-ja, institucionet lokale, drejtoritë komunale, përfaqësues të shkollave, shoqërisë civile dhe komunitetit.

Pas prezantimeve dhe diskutimeve të zhvilluara, Këshilli konstatoi sa vijon:

1. Situata e përgjithshme e sigurisë në Komunën e Podujevës mbetet stabile dhe nën kontroll, pa ndonjë incident që rrezikon sigurinë publike.

2. Policia e Kosovës raportoi për një bashkëpunim të mirë me komunitetin, dhe për përmirësim të qasjes parandaluese në shkolla dhe lagje, veçanërisht në parandalimin e dhunës në familje dhe rasteve të sjelljeve devijante tek të rinjtë.

3. Përfaqësuesit e KFOR-it dhe FSK-së konfirmuan gatishmërinë për bashkëpunim dhe ndërveprim me institucionet lokale, me qëllim të ruajtjes së paqes dhe menaxhimit të situatave emergjente.

4. Përfaqësuesit lokalë ngritën nevojën për më shumë angazhim në zonat rurale, sidomos në përmirësimin e ndriçimit publik, infrastrukturës rrugore dhe prezencën policore.

5. U theksua rëndësia e përfshirjes aktive të qytetarëve dhe bashkësive lokale në çështjet e sigurisë, si faktor kyç për ndërtimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt për të gjithë.

Në këtë mbledhje u diskutua edhe - *Informatë për sigurinë në shkolla*

Avni Fetahu, theksoi, Drejtoria Komunale e Arsimit synon krijimin e një sistemi arsimor të bazuar në cilësi, gjithpërfshirje dhe llogaridhënie, me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës. Në funksion të kësaj, DKA do të sigurojë infrastrukturë shkollore moderne, mjedis të sigurt, të qetë dhe miqësor, kuadër profesional dhe kompetent për një mësimdhënie cilësore, që do të ju mundësojë të gjithë nxënësve zhvillimin maksimal të potencialeve të tyre, në pajtim me aftësitë psikike e fizike të tyre dhe me kërkesat e shoqërisë. Shikuar në përgjithësi, dhe duke u bazuar në raportet e policisë dhe raportet e drejtorëve të shkollave, si dhe raportet e DKA në lidhje me sigurinë në shkolla, mund të themi se në këtë vit shkollor gjendja e sigurisë në shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë, stabile dhe e sigurt. Këtë konstatim e përforcon edhe më shumë mbarëvajtja e tërë procesit mësimor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Komunën e Podujevës si dhe raportet e drejtorëve të shkollave.

Mbledhja me drejtorët e shkollave

Në funksion të sigurimit të një mjedisi të qetë dhe të sigurt në institucionet shkollore, drejtori i DKA mbanë mbledhje të rregullta me të gjithë drejtorët e shkollave, në të cilën mbledhje janë trajtohen temat:

- Siguria në shkolla – masat për parandalimin e dhunës në shkolla;
- Fuqizimi i organeve udhëheqëse dhe profesionale në shkolla;

Fuqizimi dhe funksionalizimi i plotë i organeve qeverisëse – udhëheqëse dhe profesionale të shkollave

Duke ditur rolin dhe rëndësinë që kanë organet qeverisëse – udhëheqëse dhe profesionale të shkollës në zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë në arsim, por edhe në sigurimin e një mjedisi të qetë e të sigurt në shkolla, fokus të veçantë i kemi kushtuar dhe do të vazhdojmë t'i kushtojmë fuqizimit dhe funksionalizimit të plotë të tyre (Drejtorët e shkollave, Aktivitet Profesional, Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli i Nxënësve, Këshilli i Klasëve, Këshilli i Arsimtarëve, Shërbimi Pedagogjik-Psikologjik), me qëllim që këto organet ushtrojnë funksionin e tyre në ngritjen e cilësisë në arsim dhe në krijimin një mjedisi të qetë dhe të sigurt në shkolla.

Në këto mbledhje është konstatuar gjendja e sigurisë për secilën shkollë, si dhe propozimet dhe rekomandimet që kanë dalë nga ky takim janë përmbledhur në një raport nga secila shkollë dhe janë sjellë në DKA.

Bazuar në këto raporte mund të konstatojmë se gjendja e sigurisë në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë dhe e sigurt.

Zgjerimi i shërbimit psikologjik dhe pedagogjik

Në Komunën e Podujevës kemi të punësuar 9 psikologë dhe 3 pedagoge dhe 15 asistente për fëmijë me nevoja të veçanta, e që shikuar në raport me numrin e nxënësve në Komunën e Podujevës është i pamjaftueshëm.

Sigurimi i transportit të nxënësve

Komuna e Podujevës siguron transport të organizuar për të gjithë nxënësit që kanë distancë nga shtëpia në shkollë mbi 4 km., si dhe për fëmijët me nevoja të veçanta, në gjithë territorin e Komunës së Podujevës, që i vijnë në mesimet në klasat për fëmijët me nevojat e veçanta, në shfmu "Kongresi i Manastirit" në Gllamnik.

Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shkollore

Me qëllim të krijimit të infrastrukturës moderne, mjedisit të sigurt dhe miqësor për nxënësit, Komuna e Podujevës, në kuadër të planifikimeve të saj, edhe për këtë vit ka ndarë buxhet për ndërtimin, zgjerimin dhe renovimin e hapësirave shkollore.

Rregullimi i rrethojave të oborreve të shkollave

Rrethojat e oborreve të shkollave ndikojnë në ngritjen e sigurisë së shkollave, dhe duke marrë parasysh këtë fakt, Komuna e Podujevës ka bërë investime të konsiderueshme në këtë drejtim. Shumica e shkollave kanë rrethojat e tyre, mirëpo ne do të vazhdojmë edhe këtë vit të ndërtojmë rrethojat edhe në ato shkolla ku rrethoja është e dëmtuar apo nuk kanë fare.

Ndërtimi dhe rregullimi i trotuareve për këmbësor

Janë ndërtuar shumë trotuare qoftë në zona urbane, por edhe të atyre rurale, të cilat kanë ndikuar në sigurinë e këmbësorëve në përgjithësi, e sidomos sigurinë e nxënësve. Trotualet e ndërtuara për skaj rrugëve që çojnë për në shkolla, ju mundësojnë qytetarëve, e sidomos nxënësve lëvizje shumë më të sigurt, andaj kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që gjatë planifikimeve për ndërtimin e trotuareve të vazhdojë t'u jep përparësi rrugëve që shpijnë për në shkolla.

Bashkëpunimi i DKA-së me Policinë e Kosovës

Në të gjitha organizimet dhe aktivitete që kemi realizuar, e që e kemi vlerësuar të nevojshme të jenë policia, e kemi pasur mbështetjen e tyre. Gjithashtu kemi zhvilluar edhe takime të drejtpërdrejta qoftë me Komandantin e Stacionit të Policisë së Podujevës, qoftë me zyrtarët tjerë, ku i kemi bashkërenduar veprimet dhe aktivitetet e ndryshme, me qëllim që të jemi më efikas në kryerjen e punëve, detyrave dhe përgjegjësiave tona.

Prezenca e policisë në afërsi të shkollave në qytet, sidomos në shkollat e mesme të larta është e nevojshme.

Presim që ky bashkëpunim në mes DKA dhe Policisë të vazhdojë edhe më tutje, në mënyrë që të sigurojmë një mjedis të qetë dhe të sigurt për të gjithë komunitetin shkollor.

Sfidat

Përkundër vlerësimeve të gjendjes së sigurisë së përgjithshme në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Podujevës si të qetë, të sigurt dhe stabile, megjithatë kemi çështje, fatmirësisht jo të shumta, të cilave ende nuk kemi mundur t'u japim zgjidhje të plotë. Disa nga to janë: Incidentet dhe zënkat ndërmjet nxënësve; lokalet afër shkollave; qentë endacak; komunikacioni,

DKA në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për ruajtjen e rendit dhe sigurisë (drejtorinë e shkollave, organet e shkollave, policinë, QPS, OJQ etj.), do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mjedis të qetë dhe të sigurt në të gjitha institucionet edukative-arsimore.

Po ashtu ne këtë takim u diskutua edhe **-Informatë për shëndetësi**

Adelinë Stublla, Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, sa i përket informatës për shëndetësi vlen të theksohet se kemi QKMF e cila përfshinë 4 qendra tjera të mjekësisë familjare dhe 18 ambulanta, si dhe urgjencën ku trajtohen rastet e shumta, përfshirë edhe ato të rënda. Brenda mjekësisë familjare përveç shërbimeve të tjera bëhen edhe shërbime të paliativitetit (Shërbime shëndetësore në shtëpi) shërbim për të cilin qytetarët janë shumë të kënaqur. Gjithashtu ofrohen shërbimet edhe për nënat shtatzëna, për fëmijët 0-3 vjet, ku falë këtyre shërbimeve po zbulohen sëmundje të ndryshme të fëmijët. Ndër shërbime tjera në kuadër të mjekësisë familjare kryhen edhe shërbime radiologjike, mamografi, ultrazë, pediatri, gjinekologji, epidemiologji, vaksinim, infuzione, EKG, farmaci, lidhtore, ndërhyrje stomatologjike dhe shërbime laboratorike. Në QPS kryhen shumë aktivitete por për shkak të natyrës konfidenciale të rasteve puna e tyre nuk promovohet. Për herë të parë kemi siguruar edhe praninë e zyrtarëve policor për sigurinë e personelit dhe qytetarëve gjatë takimeve që

ndodhin në fazën pas divorcit. Në këtë objekt është bërë edhe instalimi i kamerave të sigurisë. Në lidhje me mirëqenie sociale jemi në proces të ndërtimit të 3 shtëpive në bashkëpunim me Shoqatën “ Jetimat e Ballkanit” përfaqësuar nga z.Halil Kastrati dhe Komunën. Dy familje të tjera janë në pritje të fillimit të ndërtimit të shtëpive. Ne i ndihmojmë vazhdimisht qytetarët me pako ushqimore. Ndër projektet që duhet përmendur është Urgjenca e re e cila është në fazën përfundimtare dhe do të ofrojë kushte moderne dhe siguri të lartë duke përfshirë praninë e dy zyrtarëve policorë, që do të jetë me orar të plotë 24 orë. Projekt tjetër është ndërtimi i Qendrës Rezidenciale për persona të moshuar e cila është e shumë pritur nga qytetarët. Dua të ju njoftoj se furnizimi me aparatura dhe barna është i kënaqshëm si në qendër ashtu edhe në terren. Falë marrëveshjes me Policinë siguria është në nivel për personelin shëndetësorë.

Mbledhja e pestë, mbajtur më 01 nëntor 2024

Këtë mbledhje e udhëheqi **znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, ku edhe u konstatuata situata si ne vijim:**

Në Komunën e Podujevës u mbajt mbledhja e pestë e Këshillit për Siguri në Bashkësi (KKSBB). Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga Policia e Kosovës, institucionet komunale, komuniteti, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Në mbledhje u diskutua situata aktuale e sigurisë në komunë, ku u theksua se gjendja e përgjithshme vazhdon të jetë e qetë dhe stabile. Policia raportoi për ulje të rasteve penale dhe shtim të bashkëpunimit me qytetarët në parandalimin e dukurive negative.

Gjithashtu, u theksua nevoja për rritje të prezencës policore në zona rurale, përmirësim të ndriçimit publik dhe zhvillimin e fushatave vetëdijesuese në shkolla.

KKSBB vlerësoi angazhimin institucional dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë për garantimin e një mjedisi të sigurt për të gjithë qytetarët e komunës.

Po ashtu u formuan këto grupe punuese;

- Formimi i Grupit punues për përgatitjen e Planit të Punës për vitin 2025

Formimi i Grupit punues për përgatitjen e Informatës për punën e KKSBB për vitin 2024

Konstatim

Nënkryetarja pas procesit të votimit konfirmoi ngritjen e Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së KKSBB-së për vitin 2025 dhe për përgatitjen e Informatës për punën e KKSBB për 2024, në përbërje:

Bashkim Bajrami

z.Mensur Hoti

z.Shemsi Jashari

z.Shefki Selmani

z.Xhafer Ademi

z.Sevdije Mustafa

z.Bahri Selimi

z.Qefser Behrami

Ndërsa në cilësinë e koordinatorit të Grupit punues caktohet Avni Fetahu.

Mbledhja e gjashtë, mbajtur më 12 dhjetor 2024 (Vazhduar më 24 dhjetor 2024)

Gjatë takimit u bë një vlerësim i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë për vitin 2024, ku u theksua se komuna ka pasur një vit stabil në aspektin e sigurisë, me një trend pozitiv në uljen e disa dukurive shqetësuese si dhuna në familje dhe incidentet e lehta kriminale.

Policia prezantoi të dhënat vjetore, ndërsa përfaqësuesit institucionalë theksuan rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve, si dhe nevojën për të fuqizuar më tej rolin e bashkësive lokale në parandalimin e problemeve të sigurisë.

Në fund, Këshilli falënderoi të gjithë akterët për angazhimin gjatë vitit 2024 dhe ritheksoi përkushtimin për vazhdimin e punës në vitin 2025 me qëllim të ruajtjes së një ambienti të sigurt dhe të qetë për të gjithë qytetarët.

Në këtë mbledhje u Miratua i propozim planit të punës së KKSBB-së për vitin 2025

Dhe u formua grupi punues në përbërje prej;

Grupi punues

Avni Fetahu
Bashkim Bajrami
Mensur Hoti
Shemsi Jashari
Shefki Selmani
Xhafer Ademi
Sevdije Mustafa
Bahri Selimi
Qefser Behrami

Podujevë, mars 2025

**Kryetari i Komunes
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL 12.05.2025
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Martin Shala, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e aktit
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. Prot. 01-016/01-0022129/25, për ndryshim dhe plotësim të përbërjes së komitetit për politikë dhe financa.
I miratuar më datë: 18.04.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 22.04.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ndërsa sa i përket përmbajtjes së aktit si dhe obligimeve ndaj palëve tjera janë në përgjegjësi të komunës.


Arsyetim

MAPL, konstaton se Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur me datë 18.04.2025 ka miratuar vendimin Nr. Prot. 01-016/01-0022129/25, për ndryshim dhe plotësim të përbërjes së komitetit për politikë dhe financa.

Vendimi Nr. Prot. 01-016/01-0022129/25, për ndryshim dhe plotësim të përbërjes së komitetit për politikë dhe financa, është në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, i cili përcakton: *Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse. Poashtu është në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë që përcakton: *Komiteti për politikë dhe financa duhet të reflektoj barazinë gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi.**

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, kuvendi i komunës së Podujevës, duhet që të ndërmer veprime të rishqyrtojë aktin dhe harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe nenit 13 paragrafi 1.2 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 11, 12.2 shkronja d), 51.1 dhe 52.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, nenit 47 paragrafi 1, dhe 48 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2025, mori këtë:

VENDIM

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-0111883/21 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa datë 30 dhjetor 2021 i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.prot.01-020/04-0093828/21 datë 07 nëntor 2022, dhe Vendimin nr.prot.01-016/01-0078834/24 datë 11 dhjetor 2024, dhe atë:

- **z.Xhevdet Maloku**, emërohet anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të znj.Drita Pajaziti e cila ka dhënë dorëheqje nga funksioni anëtare e Kuvendit të Komunës.

Neni 2


Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë nr.prot.01-020/04-0111883/21 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 30 dhjetor 2021, me ndryshim plotësimit e bëra sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-0093828/21 datë 07 nëntor 2022 dhe Vendimit nr.prot.01-016/01-0078834/24 datë 11 dhjetor 2024.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, si dhe Ligjit Nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.Prot. 01-016/01-0022129/25
Podujevë, datë, 18 prill 2025





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenëve 11, 12.2 shkronja d), 51.1 dhe 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenëve 5 dhe 6 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteve të përhershme dhe komiteve tjera në Komunë, si dhe nenëve 14, 15 paragrafi 2.4, nenin 47 paragrafi 1 dhe 48 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, dhe e vazhduar më 30 dhjetor 2021, mori këtë:

VENDIM PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Neni 1

Themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa – KPF i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

- 1- Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit (sipas pozitës)
- 2- Naim Çunaku, nga subjekti politik LDK
- 3- Qëndrim Softolli, nga subjekti politik LDK
- 4- Arisa Sylejmani, nga subjekti politik LDK
- 5- Adeliuë Stubila, nga subjekti politik LVV
- 6- Florent Hasani, nga subjekti politik LVV
- 7- Sebastina Vokri, nga subjekti politik LVV
- 8- Bashkim Sylu, nga subjekti politik PDK
- 9- Mrika Thaçi, nga subjekti politik AAK

Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas neni 1 të këtij vendimi, ndërthdet dhe është në kohëzgjatje të mandati të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual mund bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Komiteti për Politikë dhe Financa, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteve të përhershme dhe komiteve tjera në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit, dhe dispozitat tjera përkatëse në fuqi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform neni 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.01-020/04-0111883/21
Podujevë,
30 dhjetor 2021



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenëve 11, 12.2 shkronja d), 51.1 dhe 52.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përberjen dhe kompetencat e komiteteve të përherëshme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe nenëve 14, 15 paragrafi 2.4, nenit 47 paragrafi 1, dhe 48 paragrafi 2 të Statutit të Komunes së Podujevës nr.01-020/01-0050862-18, Kuvendi i Komunes së Podujevës, në mbledhjen e datës 31 tetor 2022, përkatësisht në vazhdimin e mbledhjes në 07 nëntor 2022, mori këtë,

VENDIM

Neni 1

1. Ndryshohet dhe plotësohet përberja e Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF, sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-011883/21 për themelimin dhe përberjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 30 dhjetor 2021, dhe atë:

1.1. **z.Haki Rudari**, emërohet anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të z.Feriz Hasani i cili ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa

1.2. **znj.Drita Pajazit**, emërohet anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të znj.Adelinë Stublla, e cila për arsye të emërimit në funksion ekzekutiv në Komunën e Podujevës, ka dhënë dorëheqje të paravekueshme nga Kuvendi i Komunës, respektivisht nga pozita e anëtares së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 2

Ky Vendim është pjesë përberëse e Vendimit nr.prot.01-020/04-011883/21 për themelimin dhe përberjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 30 dhjetor 2021.

Neni 3

Vendimi hyr në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunes, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.prot. 01-020/04-011883/22
Podujevë, datë: 07 nëntor 2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 51.1 dhe 52.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, nenit 47 paragrafi 1, dhe 48 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e datës 11 dhjetor 2024, mori:

VENDIM

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-0111883/21 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa datë 30 dhjetor 2021 i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.prot.01-020/04-0093828/21 datë 07 nëntor 2022, dhe atë:

- **z.Ekrem Rrahmani**, emërohet anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të z.Qendrim Softolli i cili ka dhënë dorëheqje nga funksioni anëtar i Kuvendit të Komunës.

Neni 2

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë nr.prot.01-020/04-0111883/21 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 30 dhjetor 2021, me ndryshim plotësimit e bëra sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-0093828/21 datë 07 nëntor 2022.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-016/01-0078834/24
Podujevë, datë: 11 dhjetor 2024





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës (KP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Podujevës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Keqklasifikime në kategori të ndryshme ekonomike në vlerë prej 2,166,110 €, të cilat janë realizuar përmes ekzekutimit të vendimeve gjyqësore/ përmbartimore.
- B2 Pasuritë kapitale mbi 1,000€, të raportuara në vlerë prej 115,084,498€ në Pasqyrat Financiare Vjetore, janë nënvlerësuar për 93,797€. Ndërsa pasuritë jo kapitale me vlerë nën 1,000€, të raportuara në vlerë prej 2,736,252€, janë nënvlerësuar për 203,054€ dhe mbivlerësuar për 93,797€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Podujevës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore.
- A2 Përzgjedhja e Kontraktueseve (OE) në mungesë të plotësisht të plotë të kriterëve.
- A3 Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare.
- B3 Komuna nuk kishte mbajtur regjistrat e menaxhimit të kontratave përmes platformës së e-prokurimit.
- B4 Komuna kishte paguar nga projektet jo adekuate pagesa në projekte tjera në vlerë 350,562€ pa marrë aprovimin për transfer nga Kuvendi Komunal.
- B5 Mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjor 30 ditësh.
- B6 Mungesa e projekteve ekzekutuese.
- B7 Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Podujevës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Podujevës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Podujevës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Podujevës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Podujevës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Dobësi në evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: Keqklasifikimi si rezultat i kontratave kolektive, mosregjistrimi i duhur i pasurive, mungesa e projekteve kryesore ekzekutive, mos raportimi i menaxhereve të kontratave në sistemin e E-Prokurimit, kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të buxhetit dhe të pabuxhetuara, kontraktimi i OE pa i plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, dobësi në menaxhimin e pasurive jo financiare mbi/nën 1000€, mungesa e ndërmarrjes së veprimeve në dispozicion për inkasimin e llogarive të arketueshme. Po ashtu procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur më rastin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të cilat kishin dhe gabime tjera të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korrigjimet e mundshme. Megjithatë çështjet që ndërlidhen me pasuritë dhe keqklasifikimin nuk janë paraqitur saktë dhe drejtë në PFV. Gjithashtu duhet të theksojmë se për vitin 2024 Thesari kishte ekzekutuar përmes procedurave përmbarimore/gjyqësore vlerën prej 3,861,535€, këto pagesa ishin kryesisht për kontratën kolektive të cilat ishin realizuar nga kategoria e paga dhe mëditje 1,673,274€, nga mallra dhe shërbime 368,455€, nga komunalit 28,237€, nga investime kapitale 1,791,569€ ku kryesisht ishin për kontratën kolektive, shpenzimet për procedurën përmbarimore e përfaqësimit sipas komunës ishin 712,416€.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja dhe tetë (8) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Keqklasifikim i shpenzimeve

Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parash publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 2,166,110€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas urdhrave përmbarimor të gjykatës për zbatimin e kontratës kolektive nga kategori investimet kapitale 1,769,418€, nga mallra dhe shërbime 368,455€, dhe shërbime komunale 28,237€.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi

Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpjen në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Nënvlërësimi i pasurive mbi 1,000€ dhe nën 1,000€

Gjetja Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.1. përcakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu neni 6.3. përcakton se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Pasuritë kapitale mbi 1,000€, të cilat janë raportuar me vlerë prej 115,084,498€ në nenin 19.3.1 të PVF, ishin nënvlërësuar për 93,797€, për shkak se 105 pasuri me vlerë mbi 1,000€ nuk ishin regjistruar në sistemin për pasuritë kapitale (SIMFK), por në regjistrin e pasurisë jo kapitale (e-pasuria). Si rezultat i kësaj, për të njëjtën vlerë prej 93,797€, janë mbivlerësuar i pasuritë jo kapitale, të cila në nenin 19.3.2 të PFV-ve janë raportuar me vlerë prej 2,736,252€. Përveç kësaj, kemi identifikuar se blerjet e pasurisë jo kapitale gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2024, në vlerë prej 203,054€, nuk janë regjistruar në regjistrat e pasurive jo financiare dhe nuk janë prezantuar PFV.

Më tutje theksojmë se në shpalosjen e RVF nuk ishin shpalosur pasuritë jo kapitale nën 1,000€ për sektorin e arsimit në njësi (artikull), por vetëm si total vlerë 1,848,891€ (e që nuk dihen përmbajtja e sasive dhe llojit të pasurive për arsye se nuk janë regjistruar në e-pasuri).

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në monitorimin dhe verifikimin e regjistrave të pasurisë, ku kjo pastaj ka ndikuar që pasuritë të mos jenë regjistruar në regjistrat përkatës.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurisë, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, mund të ndikon në humbjen a po tjetërsimin e pasurisë dhe prezantimin e informatave jo të plota në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale dhe jo kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore

Gjetja Neni 17 (pika 1.2) i Ligjit të Ndërtimit thotë: " leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III.

Në 3 mostra ka vonesa në lëshimin e vendimeve për lejet ndërtimore sipas afatit ligjor nga ana e Komunës pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore. Vlera totale e këtyre mostrave është 137,177€, kurse vonesat në lëshimin e lejeve ndërtimore janë prej 60 ditë deri në 200 ditë.

Kjo ka ndodhur për arsye të mosfunksionimit efektiv të kontrolleve të brendshme nga ana e zyrtarëve përgjegjës mbi trajtimin me kohë të kërkesave për lejet ndërtimore.

Ndikimi Vonesat në lëshimin e lejeve të ndërtimit do të pamundësojnë mbledhjen me kohë (inkasimin) e të hyrave nga lejet e ndërtimit.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen afatet ligjore për lëshimin e lejeve ndërtimore, duke forcuar kontrollin e brendshëm dhe mbikëqyrjen mbi trajtimin e kërkesave, në mënyrë që të mundësohet mbledhja me kohë e të hyrave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Shpërblimi më kontratë në mungesë të plotësimit të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit

Gjetja Ligji i prokurimit publik Neni 59 paragrafi 4 taksativisht parasheh: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

OE të shpërblyer me kontratë në mungesë të plotësimit të kërkesave të njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit po i paraqesim rastet si në vijim:

- Te kontratat për "Ndërtimin e kanalizimit nga fshati Lluzhan-Lupç, Gërdofc-Lluzhan, Majac-Lupç dhe Sfeqël-Lluga (Kolektori) Lloti I, II, III" në vlerë totale të kontraktuar 3,483,343€, në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit në kërkesën për kapacitetin ekonomik dhe financiar ku përveç tjera kërkohen pasqyrat financiare të audituara ndërsa (OE) në ofertën e tij ka paraqitur raportin e rishikimit të pasqyrave financiare;
- Te kontratat për "Asfaltimin e rrugëve në qytet lloti I, II dhe III" për lloti 1 në vlerë 328,174€, lloti II në vlerë 102,482€ dhe lloti III në vlerë 30,289€, në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është parapara që vetëm në një llot mund të shpërblehet një operator tutje janë kërkuar për kapacitetin teknik dhe profesional pajisjet dhe mekanizmin kërkohet në aneksi 7 më në listën e makinerisë për pikën

12 Cilindër, max 3t dhe pikën 16 kompresor për thyerjen e betonit. Në ofertën e dorëzuar për Cilindër max 3t është referuar dëshmimi më faturë 22/19 e datës 15.04.2019 dhe për kompresorin me librezën e qarkullimit, e që mungojnë në ofertë (fatura dhe librezja e qarkullimit), ndërsa OE ishte kontraktuar për tri llotet në fjalë;

- Te kontratat "Ndërtimi i Shkollës së Mesme Profesionale në Zonën Industriale" në vlerë 2,430,303€ dhe "Ndërtimi i Tregut të Gjellbërt" në vlerë 1,440,787€, në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit në kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional, kërkohet në aneksin 7 për pajisjet dhe mekanizmin me nr. rendor 1-10 kompresor për thyerjen e betonit që të dëshmohet nga pajisjet dhe mekanizmi më librezë të qarkullimit. Në ofertat e dorëzuara në shënimin për lista e makinerisë për kompresor për thyerjen e betonit tek kolona shënimet re kapitulluese për secilën pajisje ka shënuar librezën, për të cilin nuk ishte dokumenti i librezës së qarkullimit; dhe
- Te kontratat "Rregullimi i hapësirave publike përgjatë lumit LLap në qytet" ka shpërblyer më kontratë Lloti III në vlerë 82,000€ dhe Lloti IV në vlerë 38,833€, në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit në kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional, kërkohen certifikatat ISO dhe menaxherin e projektit- inxhinier i diplomuar ose bachellor i elektros përfshirë kontratën për projektin në fjalë, - Për llotin III OE fitues nuk i kishte bashkangjitur në ofertë ISO standardet, ndërsa për llotin IV OE fitues në vendimi i menaxherit të kontratës nuk i ishte referuar kontratës por për projekte të ndryshme elektrike dhe nuk ka prezantuar kontratë për projektin në fjalë.

Vlen të ceket se në asnjë tenderim autoriteti kontraktues nuk kishte kërkuar sqarim të tenderëve.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesë së funksionimit të kontrolleve të brendshme, në fushën e prokurimit.

Ndikimi

Kontraktimi i OE pa i përmbushur kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, eliminon mundësinë e një procesi të mirëfilltë të prokurimit, i cili mund të përjashtoj nga procesi OE të përgjegjshëm dhe mund të ndikoj që kontrata të mos realizohet.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare**Gjetja**

Ligji i prokurimit publik nr. 04/L-042, nenin 9 paragrafi 3 parasheh se, "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla". Po ashtu Ligji i buxhetit nr. 08/L-260 për vitin 2024, neni 12 paragrafi 7 përcakton se; "Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në rast se shpenzimet e tilla për koston totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2024 dhe për dy (2) vitet në vijim".

Kontraktimet e projekteve në mungesë të fondeve financiare janë identifikuar në këto raste si në vijim:

- Kontratat Ndërtimi i kanalizimit nga fshati Lluzhan-Lupç, Gërdofc-Lluzhan, Majac-Lupç dhe Sfeqël-Lluga (Kolektori) Lloti I, II, III në vlerë totale të kontraktuar 3,483,343€ ndërsa në PIP për vitin 2024 dhe dy vitet vijuese ka pasur mjete në vlerë 2,603,054 nga kjo rezulton një mungesë e fondeve për realizimin e projektit për 880,289€.
- Ndërtimi i shkollës në Shajkofc në vlerë të kontraktuar 594,444€ ndërsa në PIP ka pasur mjete në vlerë 300,000€ nga kjo rezulton në mungesë të fondeve për realizimin e projektit në vlerë 294,444€;
- Ndërtimi i shkollës së mesme Isa Boletini në vlerë të kontraktuar 2,566,649€ ndërsa në PIP ka pasur mjete në vlerë 1,000,000€ nga kjo rezulton në mungesë të fondeve për realizimin e projektit në vlerë 1,566,649€;
- Ndërtimi i shkollës së mesme profesionale në vlerë të kontraktuar 2,430,303€ ndërsa ka ndarje nga Ministria e Arsimit bazuar në marrëveshjen e bashkëfinancimit në vlerë 1,900,000€ pa buxhetim komunal nga kjo rezulton në mungesë të fondeve për realizimin e projektit në vlerë 530,303€;
- Ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistratja Podujevë - Prishtinë deri në rrugën Vëllezërit Frashëri në vlerë të kontraktuar 851,286€ ndërsa në PIP ka pasur mjete në vlerë 500,000€ nga kjo rezulton në mungesë të fondeve për realizimin e projektit në vlerë 351,286€; dhe
- Ndërtimi i tregut të gjelbertë në vlerë të kontraktuar 1,440,787€ ndërsa ka pasur mjete me bashkëfinancim nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në vlerë 400,000€ dhe nga komuna 44,213€ nga kjo rezulton në mungesë të fondeve për realizimin e projektit në vlerë 996,574€.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

Ndikimi

Mungesa e analizës së mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale, nënshkrim i kontratave për tej limiteve buxhetore dhe hyrja në obligime

kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, krijojnë vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare të komunës ngase duhet të bëhen shumë përshtatje buxhetore dhe ri destinime të mjeteve për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve dhe rrit rrezikun e kostove shtesë.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike të lidhura (nënshkruara) për projektet kapitale të janë në përputhje me shumën e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

Gjetja Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik".

Menaxherët e kontratave/projekteve nuk e kanë mbajtur dhe arkivuar përmes platformës së e-Prokurimit menaxhimin e kontratës dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve për mallra shërbime dhe investime kapitale.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit të kontratave përmes e-prokurimit.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikojë në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të marrë informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Pagesa e projektit nga fondet e një projekti tjetër pa miratim nga Kuvendi Komunal

Gjetja Neni 16 thekson se ndryshimet në shumën e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën programeve paragrafi 11 i Ligji nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 parasheh se "Ndryshimet në shumën e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal. Të gjitha këto ndryshime aprovohen nga Ministri". Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe kriteret e parapara me udhëzimin administrativ MF. Nr. 05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore.

Komuna kishte paguar nga projekti në projektin tjetër pa kërkuar aprovimin për transferin e mjeteve nga Kuvendi Komunal si në vijim:

- Prej fondeve të projektit 55008 "Rindërtimi i rrugëve të asfaltuara nga rruga Zahir Pajaziti.. " kishte paguar 150,000€ për projektin zgjerimi ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Xhemail Mustafa";
- Prej fondeve të projektit 51920 "Ndërtimi i një objekti të shkollës së mesme të kampusi" ka paguar dy pagesa (34,831€+65,158€) për ndërtimi e shkollës fillore të fshatit Shjakofc dhe një 20,573€ për rregullimin e infrastrukturës shkollore;
- Prej fondeve të projekti nr. 52871 "Asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave në qytet" për projektin e asfaltimi të rrugëve në fshatin Lladroc dhe Shajkofc me nr. 41167 ka paguar në vlerë 20,000€; dhe
- Prej fondeve të projekti nr. 54483 "Ndërtimi i kanalizimit të fshatit Lluzhan, Lupc .." për projektin e bashkëfinancimit për ujësjellës më KUR Prishtinën në vlerë 60,000€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve në projektet e caktuara, ku ka rezultuar në pagesa nga projektet e tjera.

Ndikimi Pagesa e projekteve nga fondet e një projekteve tjera pa miratimin për transferimin e mjeteve nga Kuvendi Komunal mund të ndikoj në dështimin e projektit të cilit ju kanë marrë mjetet.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë respektimin e procedurave për menaxhimin e fondeve, duke siguruar që çdo transferim i fondeve nga një projekt në tjetrin të miratohet paraprakisht nga Kuvendi Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Vonesa në pagesën e faturave të pranuar

Gjetja Neni 39.1 i Ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, përcakton që "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimi të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Në 4 raste me vlerë prej 424,332€, kemi vërejtur se komuna nuk kishte kryer obligimet financiare brenda afatit 30 ditësh. Vonesat ishin deri në shtatë (7) muaj nga data e pranimi të faturës.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e obligimeve rrisin rrezikun e realizimit të projekteve dhe arritjen e objektivave vjetore të komunës. Po ashtu, në rast të padive nga furnitorët mund të krijohen edhe kosto shtesë

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B6 - Mungesa e projekteve ekzekutuese****Gjetja**

Paragrafi 19.17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".

Në tri raste komuna kishte filluar procedurat e prokurimit dhe kishte lidhur kontrata pa hartuar projekt ekzekutiv dhe ato ishin si në vijim:

- Projekti për "Asfaltimi i rrugëve në qytet Llot I, II dhe III" me vlerë totale të kontraktuar 460,947€;
- Projekti për "Rregullimi i hapësirave publike përgjatë lumit LLap në qytet lloti II, III dhe IV" me vlerë totale të kontraktuar 198,582€ dhe
- "Ndërtimi i kanalizimit nga fshati Lluzhan-Lupç, Gërdofc-Lluzhan, Majac-Lupç dhe Sfeqël-Lluga lloti III" në vlerë të kontraktuar 330,452€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit të duhur para fillimit të procedurave të prokurimit, duke përfshirë mungesën e hartimit të projektit ekzekutiv për projektet specifike.

Ndikimi

Mungesa e projektit ekzekutues mund të shkaktoj vështirësi në realizimin e projekteve gjatë fazës së ekzekutimit, dhe rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B6

Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B7 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave****Gjetja**

Neni 22 i Rregullës Financiare NR.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet Urdhër blerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Në 10 raste kemi vërejt mangësitë si në vijim, si në gjashtë (6) prej tyre zotimi i mjeteve dhe urdhër-bleerja janë bërë pas datës së faturës dhe pranimit të mallit, kurse në katër (4) raste tjera urdhër blerja është proceduar pas datës së faturës dhe pranimit të mallit. Shuma totale e këtyre rasteve është 370,399€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës efektive të kontrolleve të brendshme

nga zyra e prokurimit dhe financave, gjatë realizimit të procedurave të blerjes.

Ndikimi

Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë se financat dhe zyra e prokurimit do të ndjekin të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024, ishin 1,859,659€, përderisa ishin realizuar 1,710,894€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2024, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 562,059€, si dhe të hyra nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës në vlerë 245€.

Çështja A4 - Mos raportim i rregullt për shfrytëzim të pronave komunale

Gjetja	Neni 22 paragrafi 2 i Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përcakton se "Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t'i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim". Kryetari i Komunës nuk kishte paraqitur asnjë raport periodik gjashtëmujor Kuvendit Komunal lidhur me monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme. Shkak i ndodhjes është anashkalimi i kërkesave ligjore në lidhje me raportimin dhe mbikëqyrjen e kontratave për shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.
Ndikimi	Mungesa e raportimit për monitorimin e kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim përveç se krijon pa pajtueshmëri ligjore dhe ndikon në realizimin e plotë të të hyrave.
Rekomandimi A4	Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Pasuritë jo financiare kapitale më vlerë mbi 1,000€ janë shpalosur në PFV 115,084,498€, pasuritë jo financiare jo kapitale më vlerë nën 1,000€ janë shpalosur në PFV 2,736,252€ dhe stoqe janë shpalosur në vlerë 47,777€, nga auditimi kemi hasur çështje si në vijim:

Çështja A5 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se: "Çdo fundvit bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare, tutje neni 21 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare", po ashtu neni 11.3 përcakton se: "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet dhe zhvlerësimi".

Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare dhe atë për administratën komunale dhe një pjesë të sektorit të shëndetësisë por jo dhe për drejtorinë e Arsimit, mirëpo nuk kishte bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen e pasurive më regjistrat kontabël rrjedhimisht nuk dihet diferencat në mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Tutje nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare që kanë të bëjnë me vlerësimin e pasurive të dëmtuara, vlerësimin e kërkesave për tjetërsim të pasurive si dhe përgatitjen e raportit për pasuritë që duhet të largohen nga përdorimi.

Gjithashtu duhet të theksojmë se nga analiza e shpalosjes dhe të dhënave të pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€ në PFV kemi vërejtur se akoma ka të regjistruara në kategorinë investime në vijim për vitet 2015 deri në vitin 2017 në vlerë totale 2,628,819€ të cilat përkundër që mund të jenë në përdorim akoma mbahen në regjistra si pasuri në vijim.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme lidhur me zbatimin e kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mungesës së udhëzueseve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

Ndikimi Mos krahasimi i rezultateve të rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë, po ashtu regjistrimi jo i duhur në procesin e përmbylljes së investimit kapital ka ndikim në vlerën e shpalosjes financiare të pasurive kapitale si rezultat i mos aplikimit të zhvlerësimit.

Rekomandimi A5 Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat, si dhe zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale sipas klasifikimit kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme janë shpalosur në PFV në vlerë 5,750,975€, dhe ishin nga tatimi në pronë në vlerë 4,592,068€, dhe nga qiraja në vlerë 1,143,257€ dhe tjera 15,650€ nga auditimi kemi hasur çështje si në vijim:

Çështja B8 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e Llogarive të Arkëtueshmeve (LIA) pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Kemi vërejtur që komuna nuk ka marr ndonjë veprim konkret për vitin 2024 për mbledhjen e LIA bazuar në testimet tona. Pjesëmarrjen më të madhe e kanë të arkëtueshmet për tatimin në pronë janë 4,592,068€, ndjekur nga qiraja komunale prej 1,143,257€ dhe të tjerat janë 15,650€.

Dobësitë e identifikuar lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

Ndikimi Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi B8 Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke mos përjashtuar edhe masat juridike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^a	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	31,268,469	34,540,225	33,438,552	29,739,731	24,913,687
Grante Qeveritare - Buxheti	29,183,360	30,852,693	30,627,653	27,799,690	22,300,431
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	180,268
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	225,450	225,450	46,720	0	95,756
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,103,805	1,041,660	610,627	880,898
Të hyrat vetanake	1,859,659	1,859,659	1,445,343	1,214,331	1,214,141
Donacionet vendore	0	498,096	277,177	115,083	204,186
Donacionet e jashtme	0	522	0	0	38,008

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 3,271,756€. Kjo rritje është rezultat i Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, si dhe donacioneve.


Komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 33,438,552€, por duhet të theksojmë se gjatë vitit 2024 Komunës përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore ju kanë ekzekutuar mbi rreth 3.8€ milion nga kategori të ndryshme ekonomike.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	31,268,469	34,540,225	33,438,552	29,739,731	24,913,687
Pagat dhe mëditjet	16,518,288	18,187,622	18,187,621	16,110,409	13,450,099
Mallrat dhe shërbimet	3,585,501	3,624,788	3,412,938	3,142,048	2,588,859
Komunalitë	513,000	553,309	548,117	465,147	419,968
Subvencionet dhe transferet	1,670,000	2,243,206	1,975,239	1,554,054	1,272,012
Investimet Kapitale	8,981,681	9,931,301	9,314,637	8,468,073	7,182,751

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:
 Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 1,669,334€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr.03/239 i datës 24.12.2024, për mbulimin e pagave që janë paguar përmes vendime gjyqësore përmbarimore për kontratat kolektive.
 Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 39,287€. Kjo rritje vjen nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023, për 32,085€, si dhe rritje nga donacionet për 7,202€.
 Buxheti final për komunalit ishte rritur për 40,309€. Kjo rritje vjen nga bartja e të hyrave vetjake.
 Buxheti final për subvencione ishte rritur për 573,206€, nga kjo vlerë: 420,776€, ishte rritje nga donacionet e brendshme (participimet e qytetarëve) si dhe 152,430€, nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023.
 Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 949,620€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga vitin 2023 për 878,980€, rritje nga donacionet për 70,640€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024, ishin 1,859,659€, përderisa ishin realizuar 1,710,894€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2024, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 562,059€, si dhe të hyra nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës në vlerë 245€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti filleshtar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	1,859,659	1,859,659	1,710,894	1,740,942	1,472,653
Të hyrat tatimore	848,995	848,995	347,163	666,373	515,799
Të hyrat jo tatimore	1,010,664	1,010,664	1,363,731	1,074,569	951,155
Të hyrat tjera	0	0			5,699

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare për vitin 2023 ka rezultuar me 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë, pesë (5) rekomandime janë zbatuar dhe tetë (8) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke mos përfshirë edhe masat juridike.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për ta adresuar rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë respektimin e procedurave për menaxhimin e fondeve, duke siguruar që çdo transferim i fondeve nga një projekt në tjetrin të miratohet paraprakisht nga Kuvendi Komunal.	Edhe këtë vit kemi hasur në raste të pagesave nga fondet e një projekti tjetër pa miratim nga Kuvendi Komunal.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se financat dhe zyra e prokurimit do të ndjekin të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për ta adresuar rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që zyra e prokurimit zbaton kontratën e duhur ashtu siç e parasheh rregullativa ligjore.	Nuk kemi hasur në raste të tilla, në vitin 2024.	I zbatuar
5.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.	Edhe në vitin 2024 komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të forcojë kontrollet dhe procedurat për të siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit, të gjitha zotimet për projekte janë të vlerësuara dhe të miratuara në përputhje me fondet e disponueshme.	Për vitin 2024 nuk kemi hasur raste kur Komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve.	I zbatuar
